


# Plani Vendor për Rininë 2026-2030

**Bashkia Kamëz**







Plani Vendor për Rininë 2026–2030 i Bashkisë Kamëz u përgatit me mbështetjen e iniciativës rajonale të Kombeve të Bashkuara “Të rinjtë për Përfshirje, Barazi dhe Besim”, i financuar nga Fondi për Paqen i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB.

Në Shqipëri kjo iniciativë zbatohet nga zyrat lokale të UNDP dhe UNFPA.

Përmbajtja e këtij publikimi, si dhe gjetjet, analizat dhe rekomandimet e paraqitura në të, janë përgjegjësi e Bashkisë Kamëz dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Kombeve të Bashkuara, përfshirë UNDP, UNFPA, ose Fondit për Paqen të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB.



Bashkia Kamëz

# Lista e Shkurtimeve

<b>AKPA</b>	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
<b>AKR</b>	Agjencia Kombëtare e Rinisë
<b>APAA/NEET</b>	Të rinjtë që nuk janë në arsim, punësim apo trajnim
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>JOM</b>	Programi Jashtë Orarit Mësimor
<b>KKR</b>	Këshilli Kombëtar Rinor
<b>KOKSH</b>	Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar
<b>KVR</b>	Këshilli Vendor Rinor
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>MTKS</b>	Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit
<b>NE</b>	Ndihmë Ekonomike
<b>OJF</b>	Organizata Jofitimprurëse
<b>PAK</b>	Person me Aftësi të Kufizuar
<b>PBA</b>	Programi Buxhetor Afatmesëm
<b>PVRBK</b>	Plani Vendor për Rininë i Bashkisë Kamëz
<b>ReLOaD2</b>	Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2
<b>TIK</b>	Teknologjia e informacionit dhe komunikimit
<b>UNDP</b>	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
<b>UNFPA</b>	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullatën
<b>ZVA</b>	Zyra Vendore Arsimore

# Tabela e Përmbajtjes

## **PJESA 1: KORNIZA E PËRGJITHSHME STRATEGJIKE**

<b>1.1. Panorama e përgjithshme</b>	<b>(09)</b>
<b>1.2. Të dhënat demografike</b>	<b>(10)</b>
<b>1.3. Qëllimi</b>	<b>(11)</b>
<b>1.4. Kuadri Ligjor dhe Institucional</b>	<b>(12)</b>
<b>1.5. Vizioni dhe Misioni</b>	<b>(13)</b>

## **PJESA 2: POLITIKAT RINORE NË BASHKINË KAMËZ**

<b>2.1. Hapësirat Rinore</b>	<b>(18)</b>
Infrastruktura shkollore	(18)
Terrene sportive	(18)
Qendra Kulturore	(20)
Biblioteka e Kamzës	(20)
Salla e rinisë	(20)
Parku i Liqenit të Paskuqanit	(21)
Amfiteatri i Paskuqanit	(21)
<b>2.2. Aktivitetet kulturore dhe artistike të realizuara, 2021-2025</b>	<b>(22)</b>
<b>2.3. Trajnime dhe iniciativa për edukimin dhe ndërgjegjësimin e të rinjve, 2021-2025</b>	<b>(23)</b>

<b>2.4. Këshilli Vendor Rinor</b>	<b>(24)</b>
<b>2.5. Promovimi i Bashkëpunimit me Organizatat e Shoqërisë Civile dhe partnerët ndërkombëtare</b>	<b>(25)</b>
Projekte të mbështetura financiarisht në kuadër të programit ReLOaD2 të UNDP, në periudhën 2021-2025, dhe të zbatuara nga organizata lokale të shoqërisë civile	<b>(25)</b>
Projekte rinore të tjera	<b>(25)</b>
<b>2.6. Programet e Zyrës së Punës Kamëz</b>	<b>(26)</b>
<b>2.7. Programet e Agjencisë Kombëtare të Rinisë</b>	<b>(27)</b>

### **PJESA 3: FUSHAT E NDËRHJRJES**

<b>POLITIKA 1: Fuqizimi i organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore në jetën publike dhe vendimmarrje</b>	<b>(31)</b>
<b>POLITIKA 2: Aftësimi, punësimi dhe inovacioni rinor</b>	<b>(34)</b>
<b>POLITIKA 3: Mbrojtja dhe Shëndeti Mendor e Fizik i të Rinjve</b>	<b>(37)</b>
<b>POLITIKA 4: Kultura, Tradita dhe Angazhimi Komunitar</b>	<b>(40)</b>

### **PJESA 4: MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË VENDOR PËR RININË**

<b>Qëllimi i raportit vjetor</b>	<b>(43)</b>
<b>Aneks. Plani i Veprimit dhe Aktivitetet për Rininë 2026-2030</b>	<b>(45)</b>

# KORNIZA E PËRGJITHSHME STRATEGJIKE




## 1.1 Panorama e përgjithshme

Bashkia Kamëz, qyteti i gjashtë më i madh në Shqipëri, ka një popullsi prej 150,564 banorësh dhe përfaqëson një nga zonat më të urbanizuara dhe me densitetin më të lartë të popullsisë në vend. Struktura demografike karakterizohet nga një përqindje e madhe e të rinjve, ku grupmosha 12-30 vjeç zë 31% të popullsisë, që përbën gjithsej 46,531 të rinj dhe adoleshentë. Kjo e bën Kamzën një bashki me potencial të madh rinor, por njëkohësisht kërkon planifikim të kujdesshëm për të adresuar nevojat dhe sfidat që lidhen me këtë grup të gjerë popullsi. Kamza shtrihet në një sipërfaqe prej vetëm 39.27 km<sup>2</sup>, duke e bërë atë një bashki me territor të kufizuar, por me një numër shumë të madh banorësh. Ky kontekst thekson rëndësinë e zhvillimit të një Plani Lokal të Rinisë, i cili synon të ofrojë hapësira, shërbime dhe mundësi që fuqizojnë të rinjtë dhe përforcojnë pjesëmarrjen e tyre aktive në jetën e komunitetit.

Bashkia Kamëz përfshin disa njësi dhe lagje të rëndësishme administrative, përkatësisht Njësinë Administrative Paskuqan, Lagjen Bathore, Lagjen 1 dhe Lagjen 2. Secila prej këtyre zonave ka karakteristika sociale dhe strukturore të ndryshme, të cilat ndikojnë në shpërndarjen e shërbimeve dhe mundësive për të rinjtë. Ndryshimet në nivel urbanizimi, infrastrukturë dhe akses shërbimesh krijojnë një nevojë për politika të diferencuara që marrin në konsideratë specifikat e çdo zone.

Popullsia e Kamzës është tejet e larmishme dhe johomogjene. Qyteti është ndërtuar dhe zhvilluar kryesisht nga migrimi i brendshëm ndër vite, duke krijuar një larmi të gjerë kulturash, traditash dhe zakonesh. Në Bashkinë Kamëz janë të pranishme të gjitha besimet fetare kryesore, përfshirë islamin dhe krishterimin, me xhami, kisha dhe qendra komunitare që shërbejnë si ura lidhëse midis grupeve të ndryshme të popullsisë. Ky diversitet fetar dhe kulturor pasuron jetën komunitare dhe kontribuon në krijimin e një identiteti të veçantë urban. Në territorin e bashkisë jetojnë gjithashtu 335 familje rome dhe egjiptiane, me një total prej 1,347 anëtarësh. Këto komunitete përbëjnë një segment




Në këtë kontekst, hartimi i Planit Vendor për Rininë 2026–2030 paraqitet si një domosdoshmëri për të analizuar gjendjen aktuale, për të identifikuar nevojat dhe për të ndërtuar politika që u japin të rinjve të Kamzës mundësi më të mëdha për zhvillim, pjesëmarrje dhe mirëqenie.

specifik të popullsisë që shpesh ndeshen me vështirësi të natyrës sociale, ekonomike dhe arsimore. Të rinjtë që i përkasin këtyre komuniteteve kanë nevoja të veçanta dhe kërkojnë programe të dedikuara që synojnë përfshirjen, integrimin dhe krijimin e mundësive të barabarta.

Megjithatë, ritmet e larta të urbanizimit dhe rritja e shpejtë e popullsisë kanë sjellë sfida që prekin drejtpërdrejt të rinjtë, përfshirë mungesën e hapësirave sociale dhe kulturore, presionin mbi infrastrukturën, kufizimet në hapësira të gjelbra dhe nevojën për shërbime më të specializuara. Në këtë kontekst, hartimi i Planit Vendor për Rininë 2026–2030 paraqitet si një domosdoshmëri për të analizuar gjendjen aktuale, për të identifikuar nevojat dhe për të ndërtuar politika që i japin të rinjve të Kamzës mundësi më të mëdha për zhvillim, pjesëmarrje dhe mirëqenie.

## 1.2 Të Dhënat Demografike



### Ndarje Administrative

Njësia Administrative Paskuqan,  
Lagjia Bathore, Lagjia 2, Lagjia 1



### Ekonomia

Buxheti i Bashkisë 2025:  
**6,245,161,839 Lekë**



### Fusha Sociale

- Numri total i përfituesve të PAK (Personat me Aftësi të Kufizuara) dhe kujdestarëve: **2953 persona**
- Numri total i përfituesve të Ndihmës Ekonomike (NE): **452 familje**
- Numri i të rinjve me aftësi të kufizuara, nevoja të veçanta: **240 persona**
- Numri i të rinjve (kryefamiljarë) në asistencë sociale: **10 gra kryefamiljare**



### Arsimi

Numri i nxënësve në shkollat e mesme të përgjithshme:  
**2854 nxënës**

Numri i nxënësve në shkollat profesionale:  
**1536 nxënës frekuentues**

## 1.3 Qëllimi

Qëllimi i Planit Vendor për Rininë 2026-2030 të Bashkisë Kamëz është të krijojë një platformë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme që mbështet zhvillimin e një rinie aktive, të fuqizuar dhe të aftë për të kontribuar në progresin demokratik, social dhe ekonomik të komunitetit. Plani synon të sigurojë kushte të barabarta për të gjithë të rinjtë, duke marrë parasysh diversitetin, të drejtat dhe nevojat e tyre të shumëllojshme, si dhe përfshirjen e grupeve të marginalizuara.

Ky dokument shërben si udhërrëfyes për ndërtimin e politikave efektive rinore në nivel vendor, duke vendosur në qendër fuqizimin e të rinjve përmes edukimit formal dhe joformal, zhvillimit të kompetencave, krijimit të mundësive për punësim, nxitjes së pjesëmarrjes në jetën publike dhe forcimit të statusit të tyre socio-ekonomik. Në këtë mënyrë, plani synon të kontribuojë në përmbushjen e standardeve evropiane, duke përgatitur të rinjtë e Kamzës për sfidat dhe mundësitë e ekonomisë së tregut dhe shoqërisë së globalizuar.

Plani bazohet në praktikat më të mira evropiane dhe kombëtare për politikën rinore, si dhe nga dokumentet strategjike kyçe që promovojnë angazhimin qytetar, forcimin ekonomik, përfshirjen sociale dhe zhvillimin kulturor të të rinjve.

Ai mbështet parimin se të rinjtë janë partnerë strategjikë në zhvillimin lokal dhe se politikat për rininë duhet të ndërtohen në mënyrë të koordinuar ndërmjet të gjitha strukturave të bashkisë, institucioneve në nivel qendror dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm.

Për të garantuar zbatimin efektiv të këtij plani, rëndësi të veçantë merr krijimi i sinergjive dhe bashkëpunimi i ngushtë me organizatat e shoqërisë civile, institucionet arsimore, sektorin privat dhe partnerët ndërkombëtarë.

Përmes këtij bashkërendimi synohet që burimet e disponueshme të shfrytëzohen në mënyrë optimale dhe të sigurohet ofrimi i shërbimeve cilësore për të rinjtë në të gjitha njësitë administrative të bashkisë.

Plani bazohet në praktikat më të mira evropiane dhe kombëtare për politikën rinore, si dhe në dokumentet strategjike kyçe që promovojnë angazhimin qytetar, forcimin ekonomik, përfshirjen sociale dhe zhvillimin kulturor të të rinjve.

Plani Vendor për Rininë ka në fokus ndërtimin e një komuniteti rinor pa barriera, ku të rinjtë të kenë akses të plotë në hapësira, shërbime, mundësi dhe vendimarrje, duke e shndërruar Bashkinë Kamëz në një mjedis mbështetës për potencialin, kreativitetin dhe energjinë e brezave të rinj. Qasja e tij mbështetet në politika të bazuara në evidenca, në monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm, si dhe në dedikimin e buxheteve specifike për programe rinore që përmbushin objektivat strategjike të këtij dokumenti.



## 1.4 Kuadri Ligjor dhe Institucional

Plani Vendor për Rininë 2026-2030 i Bashkisë Kamëz (PVRBK) është hartuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe strategjitë ndërkombëtare dhe kombëtare që orientojnë politikat rinore, duke siguruar harmonizim me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, përfshirjes sociale dhe fuqizimit të të rinjve.

### 1. Kuadri Ligjor Kombëtar

- ▶ Ligji nr. 75/2019 “Për Rininë”, (i ndryshuar me ligjin nr. 24/2025)<sup>1</sup>, vendos të drejtat dhe strukturat për mbrojtjen dhe promovimin e të rinjve në Shqipëri, duke krijuar Këshillin Kombëtar dhe Këshillat Vendorë të Rinisë dhe parashikuar fonde dhe hapësira rinore të sigurta, duke përfshirë:
  - ▶ VKM nr. 317, datë 4.6.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në administratën shtetërore dhe institucione e tjera publike”;
  - ▶ VKM nr.598, datë 15.10.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.969, datë 2.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Rinisë, si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij”<sup>2</sup>.
- ▶ Ligji Nr. 94/2025 “Për Vullnetarizmin”, i cili ka si synim krijimin e një kuadri rregullator e institucional të favorshëm për kryerjen e vullnetarizmit dhe nxitjen e pjesëmarrjes së individëve në vullnetarizëm, zhvillimin e vlerave njerëzore dhe solidaritetin shoqëror:<sup>3</sup>
  - ▶ Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” përcakton funksionet e bashkive në fushat e kulturës, sportit, mbrojtjes sociale, zhvillimit ekonomik e sigurisë publike.

### 2. Strategjitë Ndërkombëtare

- ▶ Agjenda Rinia, Paqja dhe Siguria (Youth, Peace and Security Agenda/ YPS), thekson rolin e të rinjve si

aktorë aktivë në ndërtimin e paqes, parandalimin e konflikteve dhe promovimin e bashkëjetesës paqësore në komunitet. PVRBK integron këtë qasje përmes programeve të edukimit qytetar, dialogut ndërkulturor dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje.

- ▶ Plani i Veprimit i BE-së për Rininë dhe Strategjia Evropiane për Rininë 2019-2027, frymëzon veprimet për përfshirjen e të rinjve në demokraci, zhvillimin e kompetencave jetësore dhe krijimin e mundësive për punësim cilësor. Plani Vendor për Rininë 2026-2030 i Bashkisë Kamëz përafron masat e tij me parimet e kësaj strategjie, në përputhje me synimin për integrim evropian.
- ▶ Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, me 17 objektiva të zhvillimit të qëndrueshëm, Agjenda 2030 mbështet fuqizimin e të rinjve përmes arsimit, punësimit, barazisë gjinore dhe pjesëmarrjes qytetare. PVRBK kontribuon në përmbushjen e këtyre objektivave në nivel lokal.

### 3. Lidhja me Strategjitë Kombëtare

- ▶ Strategjia Kombëtare për Rininë 2022-2029 udhëzon politikat kombëtare për përfshirjen dhe zhvillimin e të rinjve në arsim, punësim, pjesëmarrje, inovacion dhe mirëqenie.
- ▶ Plani Vendor për Rininë 2026-2030 është gjithashtu në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Arsimin 2021-2026, Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030, Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, Strategjinë Kombëtare të Shëndetësisë 2021-2030, etj.

### 4. Lidhja me Planet Vendore

- ▶ Plani Vendor për Rininë 2026-2030 është gjithashtu në përputhje me Planin Vendor të Shërbimeve Sociale të Bashkisë Kamëz, si dhe në kuadrin ligjor për financat publike, përfshirë Ligjin Organik për Buxhetin dhe Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA).

1. Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 75/2019, “Për rininë”, <http://qbz.gov.al/eli/ligji/2025/03/17/24>

2. Në proces bashkërendimi janë edhe katër projektvendime të tjera.

3. Ligji Nr. 94/2025 “Për Vullnetarizmin”, <http://qbz.gov.al/eli/ligji/2025/12/18/94>

## 1.5 Vizioni dhe Misioni

Bashkia Kamëz synon të jetë një bashki moderne, gjithëpërfshirëse dhe rinore, ku çdo i ri ka mundësi të barabarta për zhvillim personal, pjesëmarrje dhe mirëqenie.


### VIZIONI I PLANIT VENDOR

Nëpërmjet politikave të qëndrueshme dhe inovative, Kamza do të udhëhiqet nga angazhimi aktiv i të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe në ndërtimin e një komuniteti të qëndrueshëm, me administratë efikase dhe shërbime publike cilësore për të rinjtë.

Misioni i Bashkisë Kamëz është të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës për të gjithë qytetarët, duke vënë në qendër fuqizimin e të rinjve si motor i progresit social dhe ekonomik.

### MISIONI I PLANIT VENDOR

Bashkia angazhohet të ofrojë shërbime efikase, të përmirësojë cilësinë e jetës, të nxisë pjesëmarrjen kuptimplotë të të rinjve në veçanti dhe të qytetarëve dhe të ndërtojë një ekonomi lokale të fortë, që garanton mundësi të barabarta dhe një të ardhme më të mirë për të rinjtë.



# POLITIKAT RINORE NË BASHKINË KAMËZ



Bashkia Kamëz ka ndërmarrë disa iniciativa të suksesshme që mbështesin aktivizmin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në jetën social-politike, por që edhe janë në sinergji me parimet e Agjendës Rinia, Paqja dhe Siguria, duke ofruar mundësi për rininë. Disa nga iniciativat më të suksesshme që mund të përmendim janë:

### A. Bursat për të Rinjtë ekselentë

Programi i bursave për nxënësit ekselentë në Bashkinë Kamëz përfaqëson një nismë të rëndësishme për mbështetjen dhe motivimin e të rinjve që dallohen për rezultate të larta në arsim. Përmes këtij programi synohet të vlerësohet përkushtimi dhe puna e nxënësve, duke i inkurajuar ata të vazhdojnë të zhvillojnë potencialin e tyre akademik dhe personal.

Në kuadër të këtij programi, ofrohen bursa për nxënësit ekselentë nga arsimit bazë dhe ai i mesëm. Nxënësit e arsimit 9-vjeçar përfitojnë një mbështetje financiare mujore prej 3,000 lekësh, që arrin në 27,000 lekë në vit, ndërsa nxënësit e arsimit të mesëm përfitojnë një mbështetje financiare mujore prej 5,000 lekësh, ose 45,000 lekë në vit. Kjo mbështetje synon të lehtësojë kostot që lidhen me procesin arsimor dhe të krijojë më shumë mundësi për zhvillimin akademik dhe personal të nxënësve. Në total, mbështetja financiare për këtë program arrin deri në 4,500,000 lekë në vit. Gjatë viteve të fundit, ky program ka përfshirë një numër të konsiderueshëm nxënësish ekselentë nga shkollat e Bashkisë Kamëz. Numri i përfituesve ka qenë

i qëndrueshëm ndër vite, duke reflektuar angazhimin e vazhdueshëm të bashkisë për të mbështetur arsimin dhe për të vlerësuar arritjet e të rinjve. Në periudhën nga viti shkollor 2020-2025, një numër i madh nxënësish nga arsimi 9-vjeçar dhe nga gjimnazet kanë përfituar nga ky program, duke arritur në një total prej 1,722 nxënësish të mbështetur.

Përmes këtij programi, Bashkia Kamëz synon të krijojë një kulturë vlerësimi për arritjet akademike dhe të nxisë konkurrencën pozitive mes të rinjve, duke kontribuar njëkohësisht në zhvillimin arsimor dhe social të komunitetit.

### B. Bursa për të rinjtë në shkolla 9-vjeçare dhe Gjimnaze

Bashkia Kamëz në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit ka akorduar bursa në mbështetje të nxënësve në nevojë. Këto bursa janë dhënë për:

- ▶ Nxënës jetimë;
- ▶ Nxënës me aftësi të kufizuara (AK);
- ▶ Nxënës me prindër me aftësi të kufizuara;
- ▶ Nxënës nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike.

Qëllimi i këtij programi është të mbështesë arsimimin dhe të krijojë mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit në nevojë. Këto nxënës trajtohen me pagesë mujore **7,320 lekë** në muaj dhe **65,880 lekë** në vit.

Tabela 1. Ekselentët ndër vite Bashkia Kamëz

Viti	9 Vjeçare	Gjimnaze	Totali
2020-2021	196	106	302
2021-2022	265	115	380
2022-2023	244	85	329
2023-2024	258	82	340
2024-2025	275	96	371
<b>Totali</b>			<b>1,722</b>

### C. Bursa për nxënësit e Shkollës Profesionale Kamëz

Ministria e Financave dhe Inovacionit çdo vit ka akorduar bursa për lehtësimin e arsimit profesional dhe këto bursa ndahen në disa kategori si më poshtë:

- ▶ Nxënës jetimë;
- ▶ Nxënës me aftësi të kufizuara (AK);
- ▶ Nxënës me prindër me aftësi të kufizuara;
- ▶ Nxënës nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- ▶ Vajzat që ndjekin arsimin profesional;
- ▶ Nxënës të Pakicave Kombëtare;
- ▶ Nxënësit që ndjekin degët prioritare;
- ▶ Nxënës që përfitojnë për shkak të largësisë nga vendbanimi.

Këto nxënës trajtohen me pagesë mujore 7,320 lekë në muaj dhe 65,880 lekë në vit.

#### 1. Punësimi i të rinjve në Administratën Publike

Punësimi i studentëve ekselentë në administratë për të kontribuar me energjinë dhe idetë e tyre rinore. Aktualisht, të rinjtë përbëjnë 46% të stafit të

administratës së Bashkisë Kamëz dhe 50% të anëtarëve të këshillit bashkiak.

#### 2. Programet e praktikave dhe mbështetja për punësim

Bashkia Kamëz ofron mundësi praktike për të rinjtë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, për t'u mundësuar atyre të fitojnë përvojë dhe të hyjnë në tregun e punës.

#### 3. Partneritet me Universitetin Qirazi

Bashkia Kamëz ka krijuar partneritet me Universitetin Qirazi, duke ofruar bursa studimi për nxënësit ekselentë dhe mundësi punësimi për 5 studentë ekselentë me kontrata 1-vjeçare.

#### 4. Zhvillimi i Sportit dhe Aktivitetet Rinore

Një numër i madh aktivitetesh janë organizuar për të rinjtë, si "Ekipet Sportive" dhe "Kupa Rinore Sfida", duke përfshirë 2000 të rinj. Gjithashtu, 9 palestra shkollore janë vënë në dispozicion për zhvillimin e aktiviteteve sportive në qytet.

Tabela 2. Bursa për të rinjtë në shkolla 9-Vjeçare dhe Gjimnaze

Viti	9-Vjeçare dhe Gjimnaze
2020-2021	30
2021-2022	60
2022-2023	75
2023-2024	100
2024-2025	100
2025-2026	150
<b>Totali</b>	<b>515</b>

Tabela 3. Bursa ndër vite Shkolla Profesionale Kamëz

Viti	Shkolla Profesionale Kamëz
2020-2021	527
2021-2022	504
2022-2023	416
2023-2024	627
2024-2025	608
2025-2026	602
<b>Totali</b>	<b>3,284</b>

Tabela 4. Mbështetje financiare për ekipet sportive fituese ndër vite, Bashkia Kamëz

Viti	Disiplina	Arsimi 9-vjeçar	Arsimi i mesëm	Nr. i sportistëve	Vlera në Lekë
2021	Volejball	24	24	48	240,000
	Basket boll	24	24	48	240,000
	Futboll	12	12	24	120,000
<b>Totali 2021</b>		<b>60</b>	<b>60</b>	<b>120</b>	<b>600,000</b>
2022	Volejball	24	24	48	240,000
	Basket boll	24	24	48	240,000
	Futboll	12	12	24	120,000
<b>Totali 2022</b>		<b>60</b>	<b>60</b>	<b>120</b>	<b>600,000</b>
2023	Volejball	24	24	48	240,000
	Basket boll	24	24	48	240,000
	Futboll	12	12	24	120,000
<b>Totali 2023</b>		<b>60</b>	<b>60</b>	<b>120</b>	<b>600,000</b>
2024	Volejball	24	24	48	240,000
	Basket boll	24	24	48	240,000
	Futboll	12	12	24	120,000
	Marathon	12	6	18	180,000
<b>Totali 2024</b>		<b>72</b>	<b>66</b>	<b>138</b>	<b>780,000</b>
2025	Volejball	24	24	48	360,000
	Basket boll	24	24	48	360,000
	Futboll	12	12	24	180,000
	Shah	3	3	6	45,000
	Ping-Pong	3	3	6	45,000
<b>Totali 2025</b>		<b>66</b>	<b>66</b>	<b>132</b>	<b>990,000</b>
<b>Totali</b>		<b>318</b>	<b>312</b>	<b>630</b>	<b>3,570,000</b>

## 2.1 Hapësirat Rinore


### A. Infrastruktura shkollore

Bashkia Kamëz ofron hapësira rinore të dedikuara që mbështesin zhvillimin personal, arsimor dhe social të të rinjve, duke krijuar kushte për arsimim cilësor, formim profesional dhe angazhim aktiv në komunitet. Përgjatë viteve të fundit bashkia ka investuar në ndërtimin e godinave shkollore të reja, të cilat përmbushin standardet më të larta të kushteve dhe infrastrukturës, për t'u siguruar që çdo nxënës të ketë mundësi të shkollimit në kushte moderne dhe të sigurt.

Në territorin e Bashkisë Kamëz ndodhen:

- ▶ 19 shkolla 9-vjeçare, nga të cilat 1 është institucion arsimor jo publik;
- ▶ 7 shkolla të arsimit të mesëm, prej të cilave 6 janë të arsimit të përgjithshëm (5 publike dhe 1 jo publike) dhe 1 shkollë e arsimit profesional (publike).

Në shkollat e mesme të përgjithshme të Bashkisë Kamëz janë të regjistruar 2,854 nxënës, ndërsa në shkollat e arsimit profesional 1,536 nxënës, të cilët ndjekin programe formimi në përputhje me nevojat e tregut të punës. Ky rrjet arsimor përbën një bazë të rëndësishme për zhvillimin e rinisë, duke garantuar mundësi të barabarta arsimimi dhe një ambient të sigurt për mësim, krijimtari dhe bashkëpunim.



### Shkolla e Mesme Profesionale Kamëz

Shkolla e Mesme Profesionale Kamëz është një nga institucionet kyçe të formimit profesional në qytet. Prej disa vitesh, ajo përgatit dhe kualifikon të rinj për tregun e punës në shtatë drejtime kryesore:

- ▶ Agrobiznes
- ▶ Bujqësi
- ▶ Hoteleri-Turizëm
- ▶ Shërbime Sociale Shëndetësore
- ▶ Teknologji Informimi dhe Komunikimi
- ▶ Elektronikë
- ▶ Shërbime Mjetesh Transporti

### B. Terrene sportive

Bashkia Kamëz ka investuar në mënyrë të qëndrueshme në ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës sportive, me qëllim krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin fizik, social dhe komunitar të të rinjve. Përmes ndërtimit të palestrave moderne dhe fushave sportive multifunkionale, synohet nxitja e një stili jetese aktive dhe përfshirja e rinisë në aktivitete sportive, kulturore dhe sociale.

Në territorin e Bashkisë Kamëz janë ndërtuar dhe janë në funksion një sërë hapësirash sportive që përdoren nga shkollat, komuniteti dhe grupet rinore:

- ▶ Palestra moderne në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme, të pajisura me standarde bashkëkohore për zhvillimin e aktiviteteve fizike dhe sportive.
- ▶ Fusha sportive multifunkionale për futboll, basketboll dhe volejball, të cilat shërbejnë si hapësira komunitare për zhvillimin e aktiviteteve rinore dhe eventeve sportive.
- ▶ Rehabilitimi i terreneve ekzistuese, me qëllim rritjen e sigurisë, ndriçimit dhe aksesueshmërisë për të gjithë grupmoshat.



### Lista e disa prej terreneve sportive në territorin e bashkisë

1. Ambientet sportive tek Parku i Liqenit të Paskuqanit, 8 fusha të ndara në dy anët e Liqenit. (Fushë kalceto, tenis, volejboll, basketboll).
2. Fushat sportive në shkollën "Ibrahim Basha", Bathore;
3. Ambiente sportive në shkollën "Ahmet Zogu", Bathore;
4. Ambiente sportive dhe palestër në shkollën "Halit Coka", Bathore;
5. Fushat sportive dhe palestër në shkollën "Niko Hoxha", Valias;
6. Fusha sportive dhe palestër në shkollën "Demokracia", Valias;
7. Fusha sportive dhe palestër në shkollën "Dom Nikoll Kacorri", Laknas;
8. Ambiente sportive dhe palestër në shkollën "Fatos Lami", Zall-mner;
9. Ambiente sportive dhe palestër në shkollën "Angela Merkel", Kamëz;
10. Ambiente sportive në shkollën "100 Vjetori", Kamëz;
11. Ambiente sportive dhe palestër në Gjimnazin "Gramoz Palushi", Babrru;
12. Palestër në Gjimnazin "Isa Boletini", Paskuqan;
13. Fusha sportive dhe palestër në Gjimnazin "Ibrahim Rugova", Kamëz.

**\*Të gjitha janë qendra komunitare**

## C. Qendra Kulturore

Qendra Kulturore e Bashkisë Kamëz është një hapësirë kyçe për zhvillimin e jetës kulturore dhe aktiviteteve rinore në qytet, duke ofruar një mjedis gjithëpërfshirës, të sigurt dhe frymëzues për fëmijët e të rinjtë. Ajo përfshin salla multifunksionale për aktivitete artistike e kulturore, hapësira për ekspozita dhe evente komunitare, si dhe ambiente pune e bashkëpunimi për prova, takime e trajnime. Nëpërmjet partneriteteve me shkolla, organizata rinore dhe grupe komunitare, Qendra është shndërruar në një pikëtakim të rëndësishëm për të rinjtë e Kamzës, duke nxitur krijimtarinë, përfshirjen qytetare dhe zhvillimin e aftësive në fusha si arti, kultura, letërsia dhe debati.

**Klubi i Debatit** përfaqëson një hapësirë demokratike ku të rinjtë, anëtarë të Këshillit Vendor Rinor si dhe nxënës të shkollave dhe gjimnazeve të Kamzës, kanë mundësi të zhvillojnë aftësitë e të folurit në publik, argumentimit logjik, mendimit kritik dhe tolerancës ndaj pikëpamjeve të ndryshme. Kjo përvojë i ndihmon ata të ndërtojnë vetëbesim, kreativitet dhe aftësi lidhësi që i shërbejnë zhvillimit të tyre personal.

**Klubi i Artit - Ansambli i Valleve** përfshin të rinj të talentuar që kanë pasion për artin dhe trashëgiminë kulturore shqiptare. Përmes pjesëmarrjes në prova dhe aktivitete artistike, këta të rinj jo vetëm që ndihmohen të shprehin potencialin e tyre krijues, por edhe kontribuojnë në promovimin e identitetit kulturor të zonës dhe përfshirjen aktive në jetën artistike të komunitetit.

**Biblioteka e Kamzës** - Biblioteka e Kamzës, e vendosur në katin e dytë të Qendrës Kulturore, përfaqëson një nga hapësirat më të rëndësishme të dijes dhe formimit intelektual për të rinjtë e qytetit. Ajo shërben si një qendër leximi, studimi dhe kërkimi, ku të rinjtë kanë mundësi të huazojnë apo të përdorin një koleksion të gjerë librash, materialesh letrare dhe shkencore, duke u bërë pjesë e një komuniteti që vlerëson dijen dhe kulturën e leximit. Biblioteka synon të jetë jo vetëm një vend për studim, por edhe një hapësirë frymëzuese për reflektim, dialog dhe krijimtari, ku të rinjtë mund të gjejnë motivim për të ndjekur rrugën e dijes.

**Klubi i Leximit** - Në ambientet e bibliotekës funksionon edhe Klubi i Leximit i Bibliotekës së Kamzës, një nismë



komunitare që po fiton gjithnjë e më shumë popullaritet ndër të rinjtë. Klubi organizon takime periodike, diskutime letrare dhe aktivitete promovuese, duke nxitur shprehinë e leximit, debatin konstruktiv dhe zhvillimin e mendimit kritik.

**Salla e Rinisë** - Salla e Rinisë, e vendosur në katin e tretë të Qendrës Kulturore të Kamzës, është një hapësirë moderne e dedikuar për takime, trajnime dhe aktivitete rinore me qëllim edukimin, informimin dhe argëtimin e të rinjve. Ajo shërben si një mjedis që nxit përfshirjen aktive dhe vullnetarizmin, promovon talentet e reja dhe krijon mundësi për zhvillim personal e social. Përmes aktiviteteve interaktive dhe mbështetjes për të rinjtë në kushte të vështira, Salla e Rinisë kontribuon në fuqizimin e brezit të ri dhe në ndërtimin e një komuniteti më gjithëpërfshirës dhe aktiv.



#### D. Parku i Liqenit të Paskuqanit

Parku i Liqenit të Paskuqanit është një nga hapësirat më të rëndësishme të gjelbra të Bashkisë Kamëz, me potencial të madh për zhvillimin e politikave rinore dhe jetën komunitare. I vendosur pranë zonave të banuara dhe me akses të lehtë, ai ofron një mjedis natyror të vlefshëm për rekreacion, sport, socializim dhe aktivitete kulturore.

Me shtimin e vazhdueshëm të pemëve, lulishtes dhe sipërfaqeve të gjelbra, parku po shndërrohet në një oaz të gjallë e tërheqës, që u ofron të rinjve hapësira për relaks, eksplorim dhe lidhje me natyrën, duke sjellë një frymë të re gjallërie në komunitetin urban të Kamzës.

#### E. Amfiteatri i Paskuqanit

Një element kyç që e pasuron këtë hapësirë është amfiteatri i Paskuqanit, i cili e kthen parkun në një qendër dinamike të jetës kulturore dhe sociale. Në këtë amfiteatër zhvillohen shfaqje teatrale, performanca artistike, koncerte, aktivitete kulturore dhe evente komunitare, duke u ofruar të rinjve mundësi për t'u shprehur, për të ndarë talentet e tyre dhe për të marrë pjesë në ngjarje që forcojnë lidhjet sociale.

Amfiteatri shërben si një skenë e hapur ku rinia e Kamzës mund të angazhohet në aktivitete krijuese, të ndërtojë bashkëpunime dhe të ndiejë përkatësinë në komunitet.

## 2.2 Aktivitetet kulturore dhe artistike të realizuara, 2021-2025

### RinArt Festival – Festival Teatror për të Rinj

Festival tre-ditor i dedikuar artit skenik, me pjesëmarrjen e shkollave të mesme të Bashkisë Kamëz. Çdo grup shkolle ka punuar nën udhëheqjen e një regjisorit mentor, duke u bërë pjesë e një procesi të mirëfilltë krijues. Juria e përbërë nga aktorë dhe regjisorë profesionistë ka vlerësuar performancat dhe ka ndarë çmime për kategori të ndryshme artistike. Festivali ka synuar zhvillimin e talenteve të reja dhe afrimin e të rinjve me teatrin.

### FolkYouth Festival

Një festival tre-ditor që promovon muzikën, traditën dhe trashëgiminë kulturore shqiptare. Të rinjtë pjesëmarrës, kryesisht nga shkollat e ZVA Kamëz, kanë interpretuar në zhanrin e folkut, duke sjellë elementë të identitetit kulturor shqiptar. Mbrëmja finale është shoqëruar me atmosferë festive dhe ndarje certifikatash dhe trofesh. Ky event synon forcimin e lidhjes së të rinjve me kulturën popullore dhe krijimin e hapësirave për bashkëpunim midis tyre.



### Pikturojmë në Natyrë – 1 Maj

Aktivitet artistik i zhvilluar në natyrë, me pjesëmarrjen e nxënësve të qendrave të kurseve të qytetit të Kamzës. Të rinjtë kanë realizuar piktura të cilat më pas janë ekspozuar, duke promovuar kontaktin me natyrën dhe shprehjen e lirë artistike.

### Panairi i Librit “Kamza Lexon”

Event dy-ditor i cili bashkon disa nga shtëpitë botuese të vendit. Synimi kryesor i panairit është afrimi i të rinjve me librin, krijimi i një tradite të qëndrueshme letrare në qytet dhe pozicionimi i Kamzës në hartën e aktiviteteve kombëtare të librit. Panairi ka ofruar prezantime librash, takime me botues dhe hapësira ndërveprimi për të rinjtë.

### Festivali i Poezisë

Konkurs poetik mes shkollave të Kamzës, ku të rinjtë kanë pasur mundësi të prezantojnë krijimet e tyre origjinale si dhe interpretime nga autorë të ndryshëm. Aktiviteti ka synuar kultivimin e letërsisë tek të rinjtë, zhvillimin e aftësive krijuese dhe nxitjen e shprehjes artistike.

### Ekspozita “Temë e Lirë”

E realizuar në bashkëpunim me ZVA Kamëz, kjo ekspozitë ka synuar promovimin e të rinjve në fushën e artit pamor. Pjesëmarrësit kanë ekspozuar punime të tyre me tema të ndryshme, duke krijuar një hapësirë të vlefshme prezantimi për talentet e reja. Mundësitë për përfshirjen e të rinjve:

- ▶ Pjesëmarrje në festivale artistike dhe kulturore të dedikuara.
- ▶ Përfshirje në aktivitete krijuese, ekspozita dhe konkurse tematike.
- ▶ Angazhim në evente ku të rinjtë kanë rol aktiv si pjesëmarrës, prezantues apo kontribues artistik.
- ▶ Mundësi bashkëpunimi me profesionistë të artit, kulturës dhe edukimit përmes mentorimeve dhe udhëzimeve praktike.

## 2.3 Trajnime dhe iniciativa për edukimin dhe ndërgjegjësimin e të rinjve, 2021-2025

- ▶ **Trajnime me të rinjtë mbi qasjet e politikave rinore** nga organizata “AlbaAccess Open”, ku u diskutua mbi standardet dhe qasjet e cilësisë së politikave rinore.
- ▶ **Trajnime me të rinjtë me temë “Aftësitë komunikuese dhe e folura në publik”** nga Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) në bashkëpunim me Deloitte Albania SH.P.K për anëtarët e KVR-së dhe të rinjtë aktivë të Bashkisë Kamëz.
- ▶ **Takim konsultues nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët** për procesin e rishikimit të Ligjeve nr. 75/2019 “Për Rininë” dhe ligjit nr. 45/2016 “Për Vullnetarizmin” me pjesëmarrjen e anëtarëve të Këshillit Vendor Rinor, të rinjtë e grupeve Impact të krijuara nga World Vision dhe të rinj aktivë.
- ▶ **Workshop nga United Rights Foundation** me të rinjtë e gjimnazeve me tematikë “Sfidat e perspektivat e mbështetjes së iniciativave me ndikim komunitar nga të rinjtë për të rinjtë”.
- ▶ **Seminar Social-Edukativ** “Të rinjtë për të rinjtë duke sfiduar barrierat në aktivitetet pro-sociale me fokus mbi çështjet që shqetësojnë ata”.
- ▶ **Trajnime me të rinjtë** në kuadër të projektit “Rinia Aktive për Politikën e Qëndrueshme”, organizuar në bashkëpunim me Bashkinë Kamëz dhe me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, me të rinj nga Shkolla Profesionale dhe Këshilli Rinor.
- ▶ **Diskutim me të rinjtë** dhe gazetarin Blendi Salaj, në kuadër të muajit të letërsisë.
- ▶ Në kuadër të **“Tëtorit Rozë”**, në bashkëpunim me Këshillin Rinor u organizua aktiviteti i shpërndarjes së fjongove dhe fletëpalosjeve ndërgjegjësuere për vajzat dhe gratë në qytetin e Kamzës.
- ▶ Në kuadër të **“Ditës Ndërkombëtare të përkujtimit të Holokaustit”**, me mbështetjen e UNDP-së, UNFPA-së dhe Youth Voice Network of Organizations u zhvillua teatri multimedial “Babo Kujton gjenocidin” me të rinjtë e qytetit (gjimnazeve & KVR).



- ▶ Në kuadër të **“Ditës Botërore të Tokës”** u zhvillua një aksion pastrimi me rreth 300 të rinj përreth zonës së gjimnazit “Ibrahim Rugova”.
- ▶ Në kuadër të **Javës së Evropës 2024** “BE për përfshirjen, diversitetin dhe të drejtat e njeriut”, u zhvillua aktiviteti “Harmonia Evropiane: Koncert, ekspozitë dhe panair nën temat e përfshirjes, diversitetit dhe të drejtave të njeriut” me të rinjtë e gjimnazeve.
- ▶ Në kuadër të **“Ditës Botërore të Bicikletave”**, rreth 30 nxënës nga 3 gjimnazet e Bashkisë Kamëz (Isa Boletini; Jashar Hoxha; Ibrahim Basha), pedaluan përgjatë Parkut të Liqenit të Paskuqanit, me qëllim dhënien e mesazheve për sensibilizimin në përdorimin e biçikletave, si mjete më ekologjike të transportit.
- ▶ Në kuadër të **“Ditës Botërore të Mjedisit”**, në ambientet e shkollës 9-vjeçare “Dom Nikollë Kaçorri”, u zhvillua aktiviteti me të rinjtë e shkollës dhe stafin administrativ, në formën e një panairi me materiale të ricikluar, ku nxënësit prezantuan punimet e tyre për të pranishmit.

## 2.4 Këshilli Vendor Rinor

Këshilli Vendor Rinor në Bashkinë Kamëz luan një rol të rëndësishëm në angazhimin dhe fuqizimin e të rinjve në komunitet. Ai shërben si një mekanizëm që mundëson përfshirjen aktive të të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe në zhvillimin e qytetit.

Ky këshill drejtohet nga Kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga një grup anëtarësh që përfaqësojnë interesat dhe zërin e të rinjve. Përmes strukturës së tij dhe grupit të zgjeruar rinor, Këshilli krijon hapësira për bashkëpunim, diskutim dhe pjesëmarrje të të rinjve në çështje që lidhen me komunitetin. Roli i Këshillit Vendor Rinor përfshin organizimin e aktiviteteve dhe nismave që nxisin përfshirjen e të rinjve në jetën sociale, kulturore dhe edukative të qytetit. Përmes këtyre aktiviteteve, këshilli kontribuon në zhvillimin e komunitetit dhe në fuqizimin e të rinjve si aktorë aktivë në shoqëri. Disa nga nismat dhe aktivitetet e Këshillit Vendor Rinor Kamëz që mund të përmendim janë:

### 1. Pjesëmarrja në konsultime publike:

Këshilli Vendor Rinor është përfshirë çdo vit në konsultimet publike për hartimin e projekt-buxhetit të Bashkisë Kamëz, duke kontribuar në përcaktimin e prioriteteve që kanë të bëjnë me zhvillimin e rinisë. Vlen të theksohet se kërkesa e KVR për ngritjen e një qendre

rinore, e paraqitur gjatë këtyre konsultimeve, u vlerësua si prioritet dhe u përfshi në buxhetin e Bashkisë Kamëz për vitin 2026.

### 2. Përfshirja e zërit rinor në buxhetin e Bashkisë:

Këshilli Vendor Rinor ka siguruar përfshirjen e një zëri rinor të veçantë në buxhetin e Bashkisë Kamëz, duke mundësuar përdorimin e një fondi specifik çdo vit për aktivitete dhe projekte që mbështesin rininë dhe komunitetin.

### 3. Takimet me Kryetarin e Bashkisë:

Këshilli Vendor Rinor organizon takime dhe tryeza të rumbullakëta me Kryetarin e Bashkisë Kamëz, ku diskutohen projekte dhe nisma që kanë si fokus përmirësimin e kushteve për të rinjtë dhe zhvillimin e qytetit në përgjithësi. Ndër iniciativat më të rëndësishme të Këshillit Vendor Rinor është ajo për mundësimin e transportit pa pagesë për të gjithë studentët e qytetit të Kamzës, përmes Kartës së Studentit, një nismë që u konkretizua nga Bashkia Kamëz që prej janarit 2026.

### 4. Angazhimi në aktivitete vullnetarizmi dhe solidariteti:

Aktivitetet e vullnetarizmit janë të rëndësishme për Këshillin Rinor. Të rinjtë janë të inkurajuar të angazhohen në organizimin e ngjarjeve dhe aktiviteteve për fëmijët, ndihmën për të moshuarit dhe organizimin e aktiviteteve që promovojnë bashkëpunimin dhe solidaritetin në komunitet.

### 5. Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe artistike:

Një nismë tjetër është organizimi i aktiviteteve kulturore dhe artistike, ku rinia e Kamzës ka mundësinë të shprehë kreativitetin e saj. Aktivitetet përfshijnë ekspozita arti, performanca teatrale, koncerte dhe festivale muzikore, duke krijuar mundësi për të rinjtë të angazhohen në kulturë dhe art, dhe të kontribuojnë në pasurimin e jetës kulturore të qytetit.



## 2.5 Promovimi i Bashkëpunimit me Organizatat e Shoqërisë Civile dhe partnerët ndërkombëtare

Për të siguruar një mbështetje më të gjerë për rininë, bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë siç janë agjencitë e OKB-së (UNDP, UNFPA, UN Women, UNICEF, etj.) është i rëndësishëm.

Bashkia Kamëz ka krijuar dhe do të vijojë të zgjerojë partneritete me Caritas Albania, World Vision Albania, Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS, Liburnetik, Instituti Liberal i Tiranës PASHKO, Qatar, GIZ Albania, Kongresi Kombëtar Rinor, AIDA, Shtëpia Filmike Production Cinemania, Art & Style, Qendra ALTRI. Këto bashkëpunime mund të ofrojnë mundësi të mëtijshme për rininë për të qenë të angazhuar në aktivitete që kontribuojnë në zhvillimin e një shoqërie të qëndrueshme dhe paqësore. Projekte të mbështetura financiarisht në kuadër të programit ReLOaD2 të UNDP, në periudhën 2021-2025, dhe të zbatuara nga organizata lokale të shoqërisë civile.

1. MILIEUKONTAKT: *"Mjedis i pastër, shëndet dhe edukim cilësor"*.
2. Nisma për Ndryshim Shoqëror, ARSIS: *"Të rinj të fuqizuar, agjentë të ndryshimit dhe pjesëmarrës aktiv të nismave komunitare me natyrë sociale në Bashki"*
3. Qendra Kombëtare për Shërbime Komunitare, NCCS: *"Forcimi i karrierës dhe aftësive profesionale të të rinjve nëpërmjet promovimit të partneriteteve me Bashkinë Kamëz"*.
4. Nisma për Ndryshim Shoqëror, ARSIS: *"Rehabilitimi dhe resocializimi i fëmijëve në konflikt me ligjin dhe fëmijëve/nëna me fëmijë viktime të dhunës në familje apo trafikimit"*.
5. ART-IMPULSE: *"ART-Lens/Fuqizimi i të rinjve përmes artit"*
6. LIBURNETIK: *"Green Futures"* - ndërgjegjësimi mjedisor i të rinjve përmes edukimit interaktiv dhe përdorimit të teknologjisë.
7. Instituti Liberal i Tiranës PASHKO: *"DigiRinia-Aftësim dhe Përfshirje Dixhitale për Gjeneratën e Re"*.
8. North Green Association: *"3Xmirë" Për ty, për Mjedisin për Komunitetin - Promovimi i bashkëpunimit dhe ndryshimit pozitiv në sjelljet qytetare për mbrojtjen e mjedisit.*

### Projekte rinore të tjera

#### 1. Caritas Albania - "Your Job"

Mbështet të rinjtë 15-35 vjeç me këshillim karriere, trajnime, kurse profesionale, praktika pune dhe grante biznesi deri në 5.000 €. Ofron gjithashtu shërbime sociale për fëmijë e familje në Babrru.

#### 2. Global Care Albania - Qendra "Ditë e Re"

Mbështet fëmijët me vështirësi në të nxënë dhe aftësi të kufizuara në Bathore, si dhe ofron shërbime për komunitetin rom dhe egjiptian.

#### 3. World Vision Albania - Programi IMPACT

Që prej 2008, angazhon të rinjtë 12-20 vjeç në grupe që identifikojnë probleme komunitare dhe zhvillojnë nisma sociale për qytetari aktive.

#### 4. UNFPA & UNDP - Iniciativa rajonale e OKB-së "Të rinjtë për përfshirje barazi dhe besim"

Në kuadër të iniciativës rajonale të OKB-së, Bashkia Kamëz ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me UNDP dhe UNFPA në Shqipëri për të përfshirë agjendën "Të rinjtë, paqja dhe siguria" në politikat vendore për rininë dhe në zbatimin e iniciativave rinore të KVR apo grupeve të tjera rinore.



## 2.6 Programet e Zyrës së Punës Kamëz

Zyra e Punës në Bashkinë Kamëz luan një rol kyç në mbështetjen e qytetarëve, veçanërisht të rinjve, për integrimin në tregun e punës. Ajo vepron si një hallkë lidhëse midis kërkesës dhe ofertës, duke ofruar orientim profesional, ndërmjetësim për punësim dhe zbatim të programeve që nxisin punësimin e grupeve në nevojë. Përmes bashkëpunimit me bizneset,

Zyra ndihmon në zhvillimin e aftësive profesionale dhe rritjen e mundësive të punësimit, veçanërisht për të rinjtë. Në vitet e fundit, zyra e punës ka modernizuar ofertën e formimit profesional, duke kaluar nga profesionet tradicionale drejt fushave bashkëkohore që përputhen me nevojat e ekonomisë digjitale, si aftësitë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), programim, mirëmbajtja teknike, etj. Ky transformim synon të pajisë të rinjtë me kompetenca teknologjike e profesionale të kërkuara sot, duke e pozicionuar Zyrën e Punës Kamëz si një aktor të rëndësishëm në lidhjen midis arsimit dhe punësimit, si dhe në zhvillimin e një ekonomie lokale të qëndrueshme. Programet e nxitjes së punësimit që po zbatohen aktualisht në Bashkinë Kamëz:

### 1. Programi i Punëve Publike në Komunitet

Ky është një program 12-mujor që synon nxitjen e punësimit përmes përfshirjes në punë komunitare. Përfshin trajnerë të dedikuar (1-7 persona) dhe mbështetje financiare për pjesëmarrësit:

- ▶ **Pagesa/Subvencionimi:** ½ e pagës mesatare për grupet me 1-7 pjesëmarrës; pagë të plotë mesatare për grupet me 1-14 pjesëmarrës.
- ▶ **Mbështetje shtesë:** ½ e pagës minimale dhe sigurimet shoqërore të mbuluara nga programi.
- ▶ **Lehtësira për pjesëmarrësit:**
  - ▶ Trajnim shtesë me kupon trajnimi në vlerën 20.000 lekë;

- ▶ Mbulimi i materialeve deri në 10.000 lekë;
- ▶ Mbulimi i transportit;
- ▶ Mbështetje për ndjekjen e kopshteve dhe çerdheve për prindërit me fëmijë;
- ▶ Përshtatje e arsyeshme e vendit të punës për personat me aftësi të kufizuara (PAK).

### 2. Programi i Praktikave Profesionale

Ky program 6-mujor u drejtohet të diplomuarve në universitet dhe shkolla të mesme profesionale brenda 36 muajve të fundit, duke lehtësuar kalimin nga arsimit në tregun e punës.

- ▶ **Subvencion:** ½ e pagës minimale dhe sigurimet e aksidentit në punë (0.3% e pagës minimale).
- ▶ **Mbështetje shtesë,** bonus për grupet në disavantazh:
  - ▶ 1.600 lekë në muaj për transport;
  - ▶ 3.000 lekë në muaj për ndjekjen e kopshteve/çerdheve për prindërit e vetëm me fëmijë;
  - ▶ 200.000 lekë për punëdhënësit për përshtatjen e vendit të punës për PAK.

### 3. Programi i Vetëpunësimit

Ky program mbështet punëkërkuarit e papunë që kanë një ide biznesi dhe dëshirojnë të nisnin aktivitetin e tyre sipërmarrës. Përmblajtja e programit:

- ▶ Trajnim për zhvillimin e aftësive sipërmarrëse;
- ▶ Hartimi i planit të biznesit;
- ▶ Përfitimi i një **granti prej 500.000 lekësh të rinj** për zbatimin e idesë së biznesit.

## 2.6 Programet e Agjencisë Kombëtare të Rinisë

Bashkia Kamëz, duke u mbështetur në Politikën Kombëtare për Rininë dhe në programet e Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR), synon të rrisë pjesëmarrjen, angazhimin dhe mundësitë për të rinjtë në periudhën 2026-2030. Programet e AKR në nivel vendor përfshijnë:

### 1. Grantet për grupet informale

AKR mbështet grupet informale dhe talentet e të rinjve, duke nxitur kreativitetin, pjesëmarrjen aktive dhe zhvillimin e aftësive të lidhshme. Në bashkëpunim me Bashkinë Kamëz, ajo kontribuon në orientimin dhe fuqizimin e të rinjve për të zhvilluar projekte komunitare dhe iniciativa inovative në nivel lokal e kombëtar.

### 2. Grantet për OJF-të

Grantet për OJF-të mbështesin organizatat që punojnë me të rinjtë dhe komunitetin lokal, duke nxitur projekte inovative, edukative dhe përfshirëse që promovojnë integritetin, barazinë dhe zhvillimin profesional të të rinjve.

### 3. Garancia Rinore (duke nisur nga qershori i 2026)

Një program për mbështetjen e të rinjve APAA përmes trajnimeve, praktikave të paguara, këshillimit të hershëm të karrierës dhe pilotimit të sistemeve të paralajmërimit të hershëm për parandalimin e braktisjes shkollore. Bashkia Kamëz do të bashkëpunojë me shkollat, zyrat e punësimit dhe OJF rinore për identifikimin e të rinjve në nevojë dhe për ofrimin e mundësive për arsim, punësim dhe zhvillim personal.

### 4. Programi i fuqizimit të KVR-ve

AKR, në bashkëpunim me aktorë të tjerë, forcon kapacitetet e KVR-ve për të kontribuar në vendimmarrje dhe në zbatimin e politikave rinore. Përmes programeve si EU4Youth dhe trajnimeve tematike, planifikohen trajnimet periodike për KVR-të, grupet rinore dhe OSHC-të, duke ndihmuar Bashkinë Kamëz të krijojë kapacitete vendore të qëndrueshme.

### 5. Programi Kombëtar i Praktikave të Punës në Administratën Publike

Programi Kombëtar i Praktikave të Punës në Administratën Publike, duke përfshirë njësitë e qeverisjes vendore, i mundëson të rinjve përvojë profesionale përmes praktikave 3-mujore, kompensim financiar për angazhimin e tyre, si dhe mundësi vazhdimi pune me kontrata njëvjeçare dhe të përhershme.

### 6. Zhvillimi i shërbimeve dhe infrastrukturës rinore

Përmes granteve për njësitë e vetëqeverisjes vendore, AKR mbështeti rikonstrukcionin e bibliotekës në Kamëz, duke krijuar një hapësirë moderne për të rinjtë.

### 7. Promovimi i vullnetarizmit dhe qytetarisë aktive

Politikat e AKR për vullnetarizmin pasqyrohen në programin "Kamza Vullnetare", duke ndihmuar Bashkinë të institucionalizojë angazhimin rinor dhe ta lidhë me zhvillimin komunitar.

### 8. Koordinim dhe harmonizim me politikën kombëtare dhe BE

Reformat e AKR sigurojnë që masat e Planit Vendor për Rininë të jenë të harmonizuara me Strategjinë Kombëtare për Rininë, EU4Youth dhe praktikën evropiane, duke rritur koherencën, financueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve në Kamëz.

# POLITIKAT E PLANIT VENDOR

## POLITIKA 1

### **Fuqizimi i organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore në jetën publike dhe vendimmarrje**

Fuqizimi i të rinjve për të kontribuar aktivisht në vendimmarrje dhe proceset komunitare.

## POLITIKA 2

### **Aftësimi, Punësimi dhe Inovacioni Rinor**

Zhvillimi i aftësive të të rinjve dhe krijimi i mundësive konkrete për punësim dhe sipërmarrje.

## POLITIKA 3

### **Mbrojtja dhe Shëndeti Mendor e Fizik i të Rinjve**

Krijimi i një mjedisi mbështetës dhe të sigurt për shëndetin mendor dhe mirëqenien e të rinjve.

## POLITIKA 4

### **Kultura, Tradita dhe Angazhimi Komunitar i të Rinjve**

Promovimi i kulturës, traditës dhe angazhimit komunitar si mjete për zhvillim personal dhe social të të rinjve.

# OBJEKTIVAT

## OBJEKTIVI 1.1

Forcimi i Këshillit Vendor Rinor dhe rritja e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në vendimmarrje dhe aktivitete vendore.

## OBJEKTIVI 1.2

Forcimi i nismave rinore dhe hapësirave për zhvillimin e rinisë.

## OBJEKTIVI 1.3

Promovimi i kulturës së vullnetarizmit dhe qytetarisë aktive tek të rinjtë.

## OBJEKTIVI 2.1

Aftësimi dhe fuqizimi i të rinjve për punësim dhe zhvillim profesional.

## OBJEKTIVI 2.2

Mbështetje për tranzicionin nga arsimi drejt punësimit.

## OBJEKTIVI 2.3

Nxitja e sipërmarrjes së të rinjve dhe inovacionit.

## OBJEKTIVI 3.1

Rritja e mbështetjes psiko - sociale dhe parandalimi i sjelljeve të rrezikshme te të rinjtë.

## OBJEKTIVI 3.2

Nxitja e aktivitetit fizik, sportiv dhe rekreativ për të rinjtë.

## OBJEKTIVI 3.3

Rritja e përfshirjes sociale dhe mbështetjes për të rinjtë vulnerabël.

## OBJEKTIVI 4.1

Zhvillimi i kulturës, artit dhe sportit si mjete për përfshirjen sociale dhe pjesëmarrje rinore.

## OBJEKTIVI 4.2

Krijimi dhe funksionalizimi i hapësirave rinore komunitare në çdo njësi.

## OBJEKTIVI 4.3

Promovimi i identitetit lokal dhe qytetarisë aktive për të rinjtë.

# Politika 1

Fuqizimi i organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore në jetën publike dhe vendimmarrje

## Objektivat

### Objektivi 1.1

Forcimi i Këshillit Vendor Rinor dhe rritja e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në vendimmarrje dhe aktivitete vendore

### Objektivi 1.2

Forcimi i nismave rinore dhe hapësirave për zhvillimin e rinisë

### Objektivi 1.3

Promovimi i kulturës së vullnetarizmit dhe qytetarisë aktive tek të rinjtë

Pjesëmarrja e të rinjve në jetën publike dhe në proceset e zhvillimit lokal përbën një prioritet strategjik për Bashkinë Kamëz. Duke qenë një bashki me një strukturë demografike ku 31% e popullsisë janë të rinj dhe adoleshentë, forcimi i rolit të tyre në qeverisjen vendore është i domosdoshëm për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm, inovativ dhe gjithëpërfshirës. Analiza e situatës, konsultimet me Këshillin Vendor Rinor, organizatat partnere dhe institucionet arsimore tregojnë një nevojë të qartë për rritjen e kapaciteteve të të rinjve, përmirësimin e aksesit në informacion dhe krijimin e mekanizmave funksionale që garantojnë përfaqësim kuptimplotë dhe efektiv të rinisë në proceset vendimmarrëse.

Kjo politikë synon të krijojë kushte të përshtatshme për angazhimin aktiv të të rinjve përmes rifunksionalizimit dhe fuqizimit të Këshillit Vendor Rinor (KVR), rritjes së bashkëpunimit midis strukturave rinore në shkolla (senatet), ngritjes së platformave digjitale të komunikimit dhe programimit të aktiviteteve të Qendrës Rinore. Në këtë kuadër, do të ndërmerren masa konkrete për ngritjen e një Platforme Rinore Lokale online, organizimin e forumeve të rregullta mujore të konsultimit dhe vendosjen e një kalendari vjetor me aktivitete rinore edukative, kulturore dhe këshilluese.

Në kuadër të fuqizimit të organizimit rinor, KVR do të ristrukturohet dhe do të pajiset me trajnime periodike mbi lidërsipin, pjesëmarrjen, advokimin dhe qeverisjen vendore. Gjithashtu, do të krijohet një mekanizëm i rregullt bashkëpunimi ndërmjet KVR-së dhe senateve të shkollave për adresimin e çështjeve që prekin drejtpërdrejt të rinjtë, si siguria në shkolla, projektet rinore, nismat komunitare, kultura dhe zhvillim social. Këto ndërveprime do të rrisin kohezionin midis institucioneve vendore dhe rinisë, duke krijuar një zinxhir të qëndrueshëm komunikimi dhe konsultimi. Në drejtim të përmirësimit të komunikimit institucional, Platforma Rinore Lokale do të shërbejë si burim i qëndrueshëm për informim në kohë reale mbi nismat rinore, konsultimet publike, projektet e financuara, si dhe mundësitë për pjesëmarrje në aktivitete kulturore, artistike, edukative dhe këshilluese, si dhe për promovimin e mundësive për punësim, praktika dhe trajnime. Kjo do të ndihmojë në rritjen e transparencës dhe do të mundësojë që të rinjtë të kontribuojnë me ide, vlerësime dhe propozime për politikat lokale.

## Pjesëmarrja aktive e të rinjve në vendimmarrjen lokale është thelbësore për një zhvillim të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe demokratik në Bashkinë Kamëz.

Një tjetër shtyllë kryesore e kësaj politike është rritja e kapaciteteve rinore dhe përfshirja e tyre në nisma komunitare. Përmes granteve për nisma rinore, trajnimeve të ndryshme për lidërsip transformues, mirëqeverisje, edukim qytetar dhe pjesëmarrje demokratike, Bashkia Kamëz do të mbështesë propozimet dhe aktivitetet inovative të grupeve informale, OSHC-ve dhe grupeve të organizuara rinore. Rehabilitimi i Qendrës Kulturore dhe mbështetja për aktivitetet e Qendrës Rinore, së bashku me forcimin e shërbimeve këshilluese dhe orientuese profesionale, do të krijojnë hapësira të reja fizike dhe programore për të rinjtë. Në fushën e vullnetarizmit, politika synon të ndërtojë një kulturë qytetarie aktive përmes programit “Kamza Vullnetare” dhe krijimit të një regjistri zyrtar të vullnetarëve të bashkisë.

Të rinjtë do të angazhohen në evente komunitare në fushën e mjedisit, kulturës, solidaritetit dhe sportit. Këto aktivitete do të nxisin zhvillimin personal, përgjegjshmërinë qytetare, aftësitë sociale dhe profesionale të pjesëmarrësve. Fushatat e ndërgjegjësimit të organizuara nga bashkia, KVR, shkollat dhe partnerët do të shërbejnë për edukimin e rinisë mbi rëndësinë e pjesëmarrjes aktive, përfshirjen sociale, ndërtimin e paqes dhe barazisë.

Zbatimi i kësaj politike pritet të rrisë ndjeshëm bashkëpunimin ndërmjet institucioneve vendore, vetë të rinjve, shkollave dhe partnerëve ndërkombëtarë si UNDP, UNFPA, World Vision dhe të tjerë. Kjo do të kontribuojë në krijimin e një klime më përfshirëse, transparente dhe të orientuar drejt dialogut dhe bashkëpunimit. Ndërhyrjet e planifikuara do t'i mundësojnë të rinjve të Kamzës të jenë faktorë të rëndësishëm të zhvillimit lokal, duke ndikuar në përmirësimin e cilësisë së jetës, forcimin e institucioneve dhe ndërtimin e një komuniteti të qëndrueshëm dhe demokratik.

## Sfidat dhe Mundësitë

- Përforcimi i përfaqësimit të të rinjve:** Ka mundësi për të zgjeruar përfaqësimin gjinor dhe geografik brenda KVR, duke siguruar që çdo grup rinor të ketë zërin e vet.
- Komunikim më efikas dhe i qëndrueshëm:** Zhvillimi i një platforme digjitale rinore do të lehtësojë aksesin në informacion dhe mundësitë për të kontribuar aktivisht.
- Rritja e pjesëmarrjes në vullnetarizëm dhe aktivitete qytetare:** Programet e strukturuar të vullnetarizmit dhe qytetarisë aktive do të fuqizojnë të rinjtë dhe do të krijojnë një kulturë të qëndrueshme angazhimi komunitar.
- Zgjerimi i partneriteteve lokale dhe ndërkombëtare:** Koordinimi i mëtejshëm me shkollat, OJF-të, universitetet dhe partnerët zhvillimorë do të rrisë mbështetjen për iniciativat e të rinjve.

Tabela 5. Objektivat Strategjik, Politika 1

Nr.	Objektivi Strategjik	Aktivitetet / Masat
OS 1.1	Forcimi i Këshillit Vendor Rinor (KVR) dhe rritja e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në vendimmarrje dhe aktivitete vendore	<p>Rifunksionalizimi dhe fuqizimi i Këshillit Vendor Rinor.</p> <p>Trajnime periodike për anëtarët e KVR mbi pjesëmarrjen rinore, leadershipin dhe advokimin.</p> <p>Takime periodike ndërmjet senateve të shkollave dhe Këshillit Rinor për çështje që lidhen me projektet rinore, aktivitete, nisma komunitare, sigurinë dhe problematikat në shkolla, etj</p> <p>Krijimi i Platformës Rinore Lokale online për njoftime, konsultime dhe aktivitete rinore / promovimi i mundësive për punësim, praktika dhe kurse në Platformën Rinore Lokale.</p> <p>Programi (kalendari vjetor) i Qendrës Rinore Kamëz me aktivitete kulturore, edukuese dhe këshillimore.</p> <p>Organizimi i forumeve mujore tematike me të rinjtë për konsultim të politikave vendore.</p>
OS 1.2	Forcimi i nismave rinore dhe hapësirave për zhvillimin e rinisë	<p>Grante lokale për nisma rinore të grupeve informale dhe OSHC-ve rinore.</p> <p>Mbështetje për aktivitete të Qendrës Rinore Kamëz</p> <p>Rehabilitimi i Qendrës Kulturore</p> <p>Trajnime për leadership transformues, menaxhim konflikti dhe ndërtim paqeje për të rinjtë</p> <p>Fushata ndërgjegjësimi mbi të drejtën e pjesëmarrjes, rolin e rinisë në paqe dhe siguri, dhe parandalimin e emigracionit të paligjshëm.</p>
OS 1.3	Promovimi i kulturës së vullnetarizmit dhe qytetarisë aktive tek të rinjtë.	<p>Fushata ndërgjegjësimi për vullnetarizëm, solidaritet dhe ndërtim paqeje në komunitet.</p> <p>Krijimi i programit “Kamza Vullnetare”, me fokus ndihmë sociale, solidaritet ndërbrezor dhe parandalim të dhunës e përjashtimit social</p> <p>Krijimi dhe mirëmbajtja e regjistrit të vullnetarëve të Bashkisë Kamëz.</p> <p>Organizimi i eventeve komunitare me pjesëmarrje rinore (ambient, kulturë, sport, solidaritet).</p>

# Politika 2

Zhvillimi i aftësive të të rinjve dhe krijimi i mundësive konkrete për punësim dhe sipërmarrje

## Objektivat

### Objektivi 2.1

Aftësimi dhe fuqizimi i të rinjve për punësim dhe zhvillim profesional

### Objektivi 2.2

Mbështetje për tranzicionin nga arsimi drejt punësimit

### Objektivi 2.3

Nxitja e sipërmarrjes së të rinjve dhe inovacionit

Në vijim të angazhimit për forcimin e rolit të rinisë në zhvillimin lokal, një ndër fushat prioritare të Bashkisë Kamëz mbetet arsimit cilësor, zhvillimi i aftësive të jetës dhe nxitja e punësimit të rinjve. Konsultimet me të rinjtë, institucionet arsimore, organizatat e shoqërisë civile dhe aktorët ekonomikë treguan se shumë të rinj përballen me mungesë orientimi profesional, pamjaftueshmëri të mundësive për formim praktik dhe një shkëputje të dukshme midis sistemit arsimor dhe kërkesave të tregut të punës.

Për t'i adresuar këto sfida, kjo politikë synon një qasje të integruar që përgatit të rinjtë për punësim përmes zhvillimit të aftësive të përgjithshme, atyre teknike, digjitale, sociale dhe profesionale, duke i mundësuar një tranzicion të suksesshëm nga arsimi drejt tregut të punës. Në bashkëpunim me institucionet arsimore, bizneset vendore, Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe partnerë të tjerë publikë e privatë, Bashkia Kamëz do të zbatojë masa konkrete që lidhin më ngushtë arsimin me zhvillimin ekonomik vendor.

Një nga hapat kryesorë është krijimi dhe funksionalizimi i shërbimit të Këshillimit të Karrierës pranë Qendrës Rinore, i cili do të ofrojë orientim profesional, informim mbi programet e punësimit, procedurat e punësimit, skemat e financimit, praktikatat dhe intershipet, mbështetje për përgatitjen e CV-ve, si dhe sesione këshillimi për aftësi të jetës dhe zhvillim të karrierës. Po ashtu, Qendra Rinore do të shërbejë si pikë ofrimi e kurseve falas në aftësi të buta, arte, gjuhë të huaja dhe kompetenca digjitale, duke synuar rritjen e aksesit të rinjve në aftësim cilësor.

Bashkia Kamëz do të organizojë çdo vit panairin vjetor të punës dhe mundësive, një aktivitet që synon të lidhë të rinjtë me punëdhënësit lokalë dhe rajonalë, të promovojë profesione të reja dhe të ofrojë mundësi konkrete punësimi dhe praktike profesionale. Ndërkohë, bashkia do të zgjerojë bashkëpunimin me bizneset, institucionet publike dhe universitetet për realizimin e praktikave profesionale, duke krijuar ura më të forta midis të rinjve dhe tregut të punës.

Një tjetër fokus është identifikimi i të rinjve të kategorisë APAA dhe referimi i tyre drejt Zyrës së Punës dhe programeve të "Garancisë Rinore". Për më tepër, Bashkia Kamëz do të promovojë përdorimin e Kartës

së Studentit, duke synuar rritjen e aksesit të rinjve në shërbime, përfitime dhe mundësi mobiliteti. Në këtë kuadër, do të mbështeten edhe programet e bursave për të rinjtë ekselentë dhe ata me vështirësi ekonomike ose në risk për përjashtim social.

Një komponent i rëndësishëm i politikës është nxitja e sipërmarrjes rinore dhe inovacionit. Përmes krijimit të një hapësire co-working në Qendrën Rinore dhe ofrimit të trajnimeve në edukim financiar, menaxhim biznesi, planifikim biznesi, marketing dhe kuadrin ligjor, Bashkia Kamëz synon të krijojë një mjedis që mbështet iniciativat e të rinjve. Kjo do të shoqërohet nga programe mentorimi, grante për nisma të vogla sipërmarrëse dhe masa lehtësuese fiskale për bizneset e reja të iniciuara nga të rinjtë. Duke promovuar sipërmarrjet e qëndrueshme, ekonominë e gjelbër dhe inovacionin digjital, kjo politikë synon të rrisë potencialin krijues të rinjve si kontribuues të zhvillimit lokal.

Zbatimi i kësaj politike pritet të rrisë ndjeshëm punësueshmërinë e të rinjve, të përmirësojë kompetencat e tyre profesionale dhe të forcojë bashkëpunimin ndër-institucional në funksion të zhvillimit ekonomik vendor. Përmes një qasjeje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, Bashkia Kamëz synon të ndërtojë një ekosistem ku të rinjtë kanë mundësi reale për të mësuar, për t'u punësuar, për të ndërmarrë nisma inovative dhe për të ndërtuar një të ardhme të sigurt në komunitetin e tyre.

**Kjo politikë synon një qasje të integruar që përgatit të rinjtë për punësim dhe mundëson një tranzicion të suksesshëm nga arsimi drejt tregut të punës.**

## Sfidat dhe Mundësitë

- Zgjerimi i aftësive të të rinjve:** Ekziston potencial për rritjen e numrit të kurseve falas në aftësi të buta, digjitale, artistike dhe profesionale në Qendrën Rinore, duke synuar përfshirjen e të rinjve në të gjitha njësitet administrative.
- Forcimi i lidhjes shkollë-punë:** Panairi vjetor i punës, programet e praktikave profesionale, marrëveshjet me universitetet dhe funksionalizimi i shërbimit të këshillimit të karrierës në Qendrën Rinore janë mundësi kyçe për të rritur punësimin e të rinjve dhe për të lehtësuar tranzicionin e tyre në tregun e punës.
- Mbështetja e sipërmarrjes dhe inovacionit rinor:** Hapësira co-working<sup>4</sup>, trajnimet në menaxhim biznesi dhe programet e mentorimit krijojnë kushte për zhvillimin e ideve dhe nismave të qëndrueshme sipërmarrëse.
- Koordinim i integruar me aktorët lokalë:** Bashkëpunimi i zgjeruar me shkollat, universitetet, OSHC-të, bizneset dhe institucionet e punësimit rrit ndikimin e programeve rinore dhe siguron zgjidhje gjithëpërfshirëse për nevojat e të rinjve.

Tabela 6. Objektivat Strategjik, Politika 2

Nr.	Objektivi Strategjik	Aktivitetet / Masat
OS 2.1	Aftësimi dhe fuqizimi i të rinjve për punësim dhe zhvillim profesional	Ofrimi i kurseve për aftësitë e buta, arte, gjuhë të huaja etj. në Qendrën Rinore.
		Ofrimi i kurseve për aftësitë digjitale (program, kodim, dizajn, etj.) në Qendrën Rinore.
		Programi i bursave për të rinjtë ekselentë dhe i mbështetjes financiare për të rinjtë me vështirësi ekonomike dhe/ose në risk për përjashtim social.
		Organizimi i Panairit vjetor të punës dhe mundësive.
		Identifikimi i të rinjve të kategorisë APAA dhe referimi i tyre në Zyrën e Punës.
	Promovimi i përdorimit të Kartës së Studentit / Kartës Rinore Evropiane.	
OS 2.2	Mbështetje për tranzicionin nga arsimi drejt punësimit	Shërbime për këshillimin e karrierës dhe orientimin profesional në Qendrën Rinore (Informim për programet e punësimit, procedurat e punësimit, skemave të financimit dhe programeve për praktika dhe intershipe).
		Realizimi i praktikave profesionale në administratën vendore dhe biznese.
		Marrëveshje bashkëpunimi me universitete për orientim profesional dhe vizita në kampuse.
OS 2.3	Nxitja e sipërmarrjes së të rinjve dhe inovacionit	Krijimi i hapësirës co-working në Qendrën Rinore.
		Trajnime për edukim financiar, menaxhim biznesi, planifikim biznesi, marketing dhe kuadrin ligjor.
		Grantet për nisma të vogla të sipërmarrjes rinore.
		Lehtësime fiskale për bizneset e reja dhe/ose të iniciuara nga të rinjtë dhe të rejtat.

4. Hapësira coworking, ose hapësira e bashkëpunimit, është një koncept modern pune që ofron një mjedis të përbashkët, fleksibël dhe të pajisur me infrastrukturën e nevojshme për profesionistë të pavarur, freelancer-ë, startup-e dhe punonjës në distancë, duke reduktuar nevojën për investime të mëdha në zyra private.

# Politika 3

Krijimi i një mjedisi mbështetës dhe të sigurt për shëndetin mendor dhe mirëqenien e të rinjve

## Objektivat

### Objektivi 3.1

Rritja e mbështetjes psiko - sociale dhe parandalimi i sjelljeve të rrezikshme të të rinjtë

### Objektivi 3.2

Nxitja e aktivitetit fizik, sportiv dhe rekreativ për të rinjtë

### Objektivi 3.3

Rritja e përfshirjes sociale dhe mbështetjes për të rinjtë vulnerabël

Përmirësimi i mirëqenies psikologjike, fizike dhe sociale të rinjve përbën një prioritet kyç i Bashkisë Kamëz. Konsultimet me të rinjtë, prindërit, mësuesit dhe organizatat e shoqërisë civile treguan se problematikat që lidhen me shëndetin mendor, bullizmin, varësitë, dhunën dhe mungesën e mekanizmave të qartë për raportim vazhdojnë të jenë ndër sfidat më të ndjeshme në komunitet. Shumë të rinj shprehin pasiguri në mjediset shkollore dhe publike, ndërsa kapacitetet ekzistuese psikosociale rezultojnë të pamjaftueshme për t'iu përgjigjur nevojave në rritje.

Kjo politikë synon të krijojë një mjedis të sigurt, mbrojtës dhe gjithëpërfshirës për të rinjtë e Kamzës, duke e konsideruar shëndetin mendor dhe fizik si pjesë thelbësore të zhvillimit të qëndrueshëm të komunitetit. Përmes një qasjeje të koordinuar ndër-institucionale, Bashkia Kamëz do të forcojë mekanizmat e mbrojtjes, do të zgjerojë aksesin në shërbimet psikosociale dhe do të nxisë ndërgjegjësimin e komunitetit për rëndësinë e kujdesit afatgjatë ndaj shëndetit mendor dhe mirëqenies emocionale.

Në këtë kuadër, Bashkia Kamëz do të ngrrejë Komitetin Ndërinstitucional Vendor për Rininë, si mekanizëm formal koordinimi ndërmjet institucioneve që punojnë me dhe për të rinjtë. I drejtuar nga Kryetari ose Nënkyetari i Bashkisë përgjegjës për politikën sociale dhe me përfaqësim nga arsimi, shëndetësia, policia, punësimi, strukturat e rinisë, Këshilli Vendor Rinor dhe organizatat e shoqërisë civile, komiteti do të mbledhet periodikisht për të forcuar bashkëpunimin ndërsektorial dhe për të përmirësuar referimin dhe mbështetjen për të rinjtë në komunitet.

Një ndër masat më të rëndësishme është vendosja e psikologëve të dedikuar në Qendrën Rinore, të cilët do të ofrojnë këshillim individual dhe në grup, si dhe do të bashkëpunojnë me shkollat, mjekët e familjes dhe organizatat partnere për identifikimin, referimin dhe menaxhimin e rasteve që kërkojnë mbështetje profesionale. Krahas kësaj, do të organizohen forume të hapura me të rinj për parandalimin e sjelljeve antisociale, kriminalitetit dhe për nxitjen e komunikimit pa dhunë dhe zgjidhjes paqësore të konflikteve.

Në drejtim të parandalimit të bullizmit, dhunës, varësive dhe sjelljeve të rrezikshme, Bashkia Kamëz do të zhvillojë fushata sensibilizuese vjetore, programe edukimi për

vetëvlerësimin, imazhin trupor, shëndetin seksual dhe riprodhues, si dhe fushata ndërgjegjësimi për shëndetin mendor, të cilat synojnë t'u ofrojnë të rinjve informim të sigurt dhe të aksesueshëm. Përmes sesioneve informuese mbi sigurinë në internet për të rinjtë, prindërit dhe mësuesit, synohet reduktimi i risqeve të bullizmit kibernetik dhe përdorimit të rrezikshëm të teknologjisë.

Për të forcuar mekanizmat e raportimit dhe reagimit, Bashkia Kamëz do të krijojë "Klubet e Sigurisë" në gjimnaze dhe një linjë raportimi "Të rinjtë për të rinjtë", duke i fuqizuar vetë të rinjtë si aktorë që kontribuojnë në parandalimin e rasteve problematike dhe në mbështetjen e bashkëmoshatarëve. Nëpërmjet shërbimeve të zgjeruara të këshillimit dhe referimit, do të sigurohet ndihma e duhur për rastet sociale, psikologjike ose ligjore, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet lokale dhe kombëtare.

Mirëqenia mendore plotësohet nga promovimi i aktivitetit fizik dhe stilit të shëndetshëm të jetës. Përmes Programit "Jashtë Orarit Mësimor" (JOM), mbështetjes së ekipeve sportive në shkollë, organizimit të "Javës Evropiane të Sportit", si dhe promovimit të aktiviteteve rekreative në natyrë si biçikletë, hiking dhe ecje, Bashkia Kamëz do të nxisë aktivizimin e të rinjve, forcimin e shëndetit fizik dhe krijimin e komuniteteve sportive gjithëpërfshirëse.

Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet të rinjve vulnerabël dhe atyre në rrezik braktisjeje shkolle ose përfshirjeje kriminale. Për ta, Bashkia Kamëz do të zbatojë programe për përfshirjen sociale, aktivitete integruese, sport adaptiv dhe programe kundër dhunës, trafikimit dhe radikalizmit të dhunshëm. Paralelisht, do të monitorohen situatat e rrezikut në komunitet dhe shkollë dhe do të mbështeten organizatat e shoqërisë civile që punojnë në fushat e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore, pranimit të diversitetit dhe komunikimit pa dhunë.

Nëpërmjet kësaj qasjeje gjithëpërfshirëse, Bashkia Kamëz synon të ndërtojë një sistem të qëndrueshëm kujdesi dhe mbrojtjeje për të rinjtë, ku shëndeti mendor, mirëqenia fizike dhe siguria trajtohen si çështje prioritare të politikave publike. Kjo politikë synon që të gjitha vajzat dhe djemtë e Kamzës të rriten në një mjedis ku ndihen të sigurt, të mbështetur dhe të aftësuar për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë.

## Sfidat dhe Mundësitë

- Zgjerimi i mekanizmave të mbrojtjes:** Krijimi i linjave të raportimit, klubeve të sigurisë dhe forcimi i koordinimit ndërinstytucional përbëjnë mundësi reale për të rritur mbrojtjen e të rinjve.
- Forcimi i shërbimeve psikosociale:** Rritja e numrit të psikologëve, këshilltarëve dhe specialistëve të dedikuar siguron një sistem më të gjerë dhe të personalizuar të mbështetjes psikosociale.
- Promovimi i shëndetit mendor dhe mirëqenies emocionale:** Fushatat sensibilizuese, programet edukative, forumet e hapura dhe platformat online mund të rrisin informimin dhe të krijojnë një kulturë më të hapur për kërkimin e ndihmës profesionale.
- Bashkëpunimi me partnerët lokalë dhe evropianë:** Rritja e bashkëpunimit me OJF-të, shkollat, institucionet shëndetësore dhe mediat lokale ofron mundësi për një ndikim më të gjerë dhe përfshirje të qëndrueshme të të rinjve.

Tabela 7. Objektivat Strategjik, Politika 3

Nr.	Objektivi Strategjik	Aktivitetet / Masat
OS 3.1	<b>Rritja e mbështetjes psikosociale dhe parandalimi i sjelljeve të rrezikshme të rinjtë</b>	Vendosja e psikologëve të dedikuar në Qendrën Rinore për këshillim individual dhe në grup.
		Fushata sensibilizuese mbi bullizmin, varësitë, shëndetin seksual dhe riprodhues.
		Fushata ndërgjegjësimiti “Nuk je vetëm”, për shëndetin mendor.
		Sesione informuese mbi sigurinë në internet për të rinjtë, prindërit dhe mësuesit.
		Krijimi i “Klubeve të Sigurisë” në çdo gjimnaz dhe vendosja e linjës së raportimit “Të rinjtë për të rinjtë”.
		Organizimi i forumeve të hapura me të rinj për parandalimin e sjelljeve antisociale dhe kriminalitetit, si dhe për nxitjen e komunikimit pa dhunë, zgjidhjen paqësore të konflikteve dhe kërkimin e ndihmës.
		Aktivitete me të rinj në rrezik braktisjeje shkolle ose përfshirjeje kriminale.
OS 3.2	<b>Nxitja e aktivitetit fizik, sportiv dhe rekreativ për të rinjtë</b>	Programi “Jashtë Orarit Mësimor” (JOM) me aktivitete sportive, artistike dhe rekreative.
		Mbështetja e Programit të Ekipeve Sportive në shkolla
		Aktivitete sportive (Lëvizja në natyrë me biçikleta; hiking, etj.)
		Organizimi i “Javës Evropiane të Sportit”.
OS 3.3	<b>Rritja e përfshirjes sociale dhe mbështetjes për të rinjtë vulnerabël</b>	Funksionimi i Komitetit Ndërinstytucional Vendor për Rininë
		Aktivitete për të rinj me aftësi të kufizuara (aftësim, aktivitete integruese, sport adaptiv).
		Monitorimi i situatave të rrezikut për të rinjtë në komunitet dhe shkolla.
		Mbështetje për OSHC që punojnë për të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe pranimin e diversitetit.
		Fushata informuese për “Javën e Evropës”, njohja me Bashkimin Evropian dhe të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve.

# Politika 4

Zhvillimi i aftësive të të rinjve dhe krijimi i mundësive konkrete për punësim dhe sipërmarrje

## Objektivat

### Objektivi 4.1

Aftësimi dhe fuqizimi i të rinjve për punësim dhe zhvillim profesional

### Objektivi 4.2

Mbështetje për tranzicionin nga arsimi drejt punësimit

### Objektivi 4.3

Nxitja e sipërmarrjes së të rinjve dhe inovacionit

Zhvillimi kulturor dhe angazhimi komunitar përbëjnë një shtyllë të rëndësishme të Planit Vendor për Rininë 2026-2030 të Bashkisë Kamëz, duke u konsideruar si elementë thelbësorë për mirëqenien sociale, forcimin e identitetit lokal dhe rritjen e pjesëmarrjes qytetare të të rinjve. Konsultimet me të rinjtë dhe aktorët komunitarë nxorën në pah nevojën për më shumë hapësira kulturore, aktivitete kreative, promovim të traditave lokale dhe mbështetje për talentet e reja në art, kulturë dhe sport. Të rinjtë shprehën gjithashtu dëshirën për të kontribuar aktivisht në jetën e komunitetit, veçanërisht në fushat e mjedisit, kulturës dhe shërbimit komunitar, duke theksuar se mjediset aktuale ofrojnë pak mundësi për shprehje artistike dhe iniciativë rinore.

Për të adresuar këto nevoja, Bashkia Kamëz ka vendosur të investojë në zhvillimin e kulturës, artit dhe sportit si mjete për përfshirje sociale dhe pjesëmarrje rinore. Promovimi dhe fuqizimi i sistemit të garave shkollore, futja e disiplinave të reja sportive dhe nxitja e pjesëmarrjes së vajzave synojnë të fuqizojnë të rinjtë dhe të garantojnë qasje të barabartë në aktivitetet sportive. Aktivitetet kulturore si Festivali vjetor “Rinia Art Kamza”, Festivali Teatror “RinArt”, Festivali “FolkYouth”, Panairi i Librit “Kamza Lexon”, ekspozitat periodike, bashkëpunimet me artistë lokalë dhe panairët për artizanët e rinj krijojnë një platformë të qëndrueshme për promovimin e talenteve të reja dhe pasurimin e jetës kulturore të qytetit. Po ashtu, kampet verore, dimërore dhe bootcamp-et tematike u ofrojnë të rinjve hapësira dinamike për zhvillimin e aftësive krijuese, bashkëpunuese dhe profesionale.

Një komponent kyç i kësaj politike është krijimi dhe funksionalizimi i hapësirave rinore komunitare në çdo njësi administrative, përmes aktiviteteve si shfaqjet e filmave dhe dokumentarëve në hapësira publike (kinema verore dhe kinema të improvizuara), shfaqjet artistike në ambiente të hapura dhe shndërrimi i shkollave në qendra komunitare të aksesueshme gjatë gjithë vitit. Këto hapësira synojnë të bëhen pika takimi për të rinjtë, ku ata mund të mësojnë, shprehen, bashkëpunojnë dhe të ndërtojnë lidhje të forta komunitare. Po ashtu, nismat e pastrimit dhe gjelbërimit, aktivitetet për përdorimin e kohës së lirë, koncertet e hapura, “ditët e lagjes” dhe lojërat popullore synojnë të nxisin kulturën e pjesëmarrjes, solidaritetin dhe bashkëpunimin ndërmjet brezave.

Zhvillimi kulturor dhe angazhimi komunitar janë elementë thelbësorë për mirëqenien sociale, forcimin e identitetit lokal dhe rritjen e pjesëmarrjes qytetare të të rinjve.

Në këtë kuadër, Bashkia Kamëz vendos theks të veçantë te promovimi i identitetit lokal dhe qytetarisë aktive, duke mbështetur fushata të drejtuara nga të rinjtë për promovimin e vlerave të komunitetit, historisë së Kamzës, figurave lokale dhe trashëgimisë kulturore.

Panairi Artizanal “Trashëgimia Kulturore dhe Identiteti Kombëtar”, panairët e ushqimeve tradicionale, punëtoritë kreative dhe trajnimet në menaxhim kulturor dhe organizim aktiviteteve komunitare synojnë të pasurojnë kompetencat e të rinjve në organizimin e aktiviteteve, menaxhimin e eventeve dhe zhvillimin e projekteve kulturore. Gjithashtu, trajnimet në menaxhim biznesi dhe marketing për artistët dhe artizanët e rinj synojnë t'i pajisin ata me njohuritë e nevojshme për të transformuar talentin e tyre në modele të qëndrueshme ekonomikisht.

Kjo politikë i jep prioritet krijimit të një mjedisi të hapur, të gjallë dhe kreativ, ku të rinjtë e Kamzës ndihen të fuqizuar për të promovuar kulturën, për të ruajtur traditat, për t'u angazhuar në komunitet dhe për të ndërtuar një identitet qytetar aktiv. Përmes aktiviteteve të vazhdueshme dhe bashkëpunimeve me institucionet kulturore, shkollat, organizatat e shoqërisë civile dhe artistët lokalë, Bashkia Kamëz synon të shndërrohet në një qendër të zhvillimit kulturor, ku kultura, arti, tradita dhe komuniteti bashkohen për të nxitur kreativitetin, bashkëjetesën dhe mirëqenien e të rinjve. Bashkia Kamëz ka zhvilluar iniciativa të rëndësishme për të nxitur pjesëmarrjen rinore në kulturë, art, sport dhe aktivitete komunitare. Këto aktivitete kanë krijuar hapësira për zhvillim personal, përfshirje sociale dhe promovim të identitetit lokal.

## Sfidat dhe Mundësitë

- Zgjerimi i mundësive për pjesëmarrje rinore:** Krijimi dhe funksionalizimi i hapësirave rinore komunitare, përfshirë Qendrën Rinore dhe Pallatin e Kulturës, rrit aksesin e të rinjve në aktivitete kulturore, artistike dhe komunitare.
- Rritja e aktivitetit dhe ofertës kulturore-sportive:** Organizimi i festivaleve, panairove, kampeve dhe programeve kulturore-sportive forcon pjesëmarrjen rinore, promovon talentet e reja dhe mbështet zhvillimin e artit, kulturës dhe sportit.
- Forcimi i identitetit dhe qytetarisë lokale:** Promovimi i trashëgimisë kulturore, historisë dhe figurave lokale, përmes aktiviteteve dhe panairove tematike, nxit qytetarinë aktive dhe përkatësinë komunitare të të rinjtë.
- Bashkëpunimi me partnerët lokalë dhe ndërkombëtarë:** Bashkëpunimi me institucione, organizata dhe artistë kontribuon në rritjen e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së aktiviteteve kulturore dhe komunitare për të rinjtë.

Tabela 8. Objektivat Strategjik, Politika 4

Nr.	Objektivi Strategjik	Aktivitetet / Masat
OS 4.1	Zhvillimi i kulturës, artit dhe sportit si mjete për përfshirje sociale dhe pjesëmarrje rinore	Promovimi dhe fuqizimi i sistemit të garave shkollore dhe më gjerë si dhe futja e disiplinave të reja sportive, me fokus tek vajzat e reja. (Sfida 2026, Open Kamza, Aktivitete sportive maratona, etj).
		Organizimi i Festivalit Teatror “RinArt”.
		Organizimi i Festivalit “FolkYouth”.
		Organizimi i Panairit të Librit “Kamza Lexon”.
		Bashkëpunime me artistë vendas, institucione kulturore dhe organizata për organizimin e ekspozitave, performancave dhe punësive artistike..
		Organizimi i aktiviteteve promovuese dhe panairove për artistët dhe artizanët e rinj të Kamzës, ekspozita në ambiente publike, shkolla dhe Qendrën Rinore.
OS 4.2	Krijimi dhe funksionalizimi i hapësirave rinore komunitare në çdo njësi	Kampe verore, dimërore /Bootcamp për tematika të ndryshme.
		Shfaqje filmash dhe dokumentarësh në hapësira publike (kinema verore, kinema të improvizuara)
		Nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve në nisma të pastrimit, gjelbërimit dhe mbrojtjes së mjedisit.
OS 4.3	Promovimi i identitetit lokal dhe qytetarisë aktive për të rinjtë	Aktivitetet komunitare për përdorimin e kohës së lirë: koncerte të hapura, “ditët e lagjes”, lojëra popullore, aktivitete sportive në komunitet.
		Panairi Artizanal “Trashëgimia Kulturore dhe Identiteti Kombëtar”
		Promovimi i të rinjve që përbejnë vlerë për komunitetin, historinë e Kamzës dhe figurave lokale
		Punëtori kreative dhe trajnime në menaxhim kulturor dhe organizim aktiviteteve komunitare.

# MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT TË PLANIT VENDOR PËR RININË



Monitorimi dhe vlerësimi përbëjnë një komponent thelbësor të zbatimit të Planit Vendor për Rininë, duke siguruar që objektivat strategjike dhe aktivitetet e planifikuara të realizohen në mënyrë efektive dhe në përputhje me nevojat reale të të rinjve të Bashkisë Kamëz. Për periudhën e planifikuar, Bashkia Kamëz do të zbatojë një mekanizëm të strukturuar, transparent dhe të qëndrueshëm monitorimi, i cili garanton matjen e progresit, transparencën ndaj publikut dhe rritjen e përfshirjes së të rinjve në proceset e vendimmarrjes.

Ky mekanizëm do të mbështetet në mbledhjen sistematike të të dhënave, raportim të rregullt dhe analiza vjetore të performancës, duke mundësuar identifikimin e praktikave të mira, adresimin e sfidave dhe përshtatjen e aktiviteteve gjatë rrugës. Monitorimi do të kryhet nëpërmjet treguesve të përcaktuar për secilin objektiv strategjik dhe për secilën politikë, të cilët janë të përfshirë në planin e veprimit dhe shërbejnë si bazë për matjen e progresit dhe vlerësimin e rezultateve.

Në këtë proces, stafi i Qendrës Rinore Kamëz do të ketë një rol kyç së bashku me drejtoritë përkatëse në bashki, duke koordinuar mbledhjen dhe analizën e të dhënave, duke monitoruar progresin në të gjitha objektivat strategjike dhe nën-aktivitetet e planit, dhe duke siguruar përfshirjen aktive të aktorëve lokalë, shkollave, qendrave rinore dhe organizatave të shoqërisë civile, për një panoramë gjithëpërfshirëse të progresit vjetor.

## Qëllimi i raportit vjetor

Raporti vjetor i monitorimit synon të:

- ▶ **jap një panoramë të qartë**, të saktë dhe të përditësuar të ecurisë së zbatimit të Planit Vendor për Rininë,
- ▶ **evidentojë arritjet kryesore të vitit** dhe kontributin e aktiviteteve në përparimin drejt objektivave strategjike,
- ▶ **identifikojë pengesat**, vështirësitë dhe faktorët që kanë ndikuar negativisht në zbatimin e aktiviteteve,
- ▶ **propozojë rekomandime konkrete** për përmirësimin e zbatimit në vitet e ardhshme,

- ▶ krijojë bazën e nevojshme për planifikimin buxhetor dhe programimin vjetor të aktiviteteve për rininë.

Raporti do të shërbejë si dokumenti kryesor i llogaridhënies publike për të gjitha politikat dhe shërbimet rinore që Bashkia Kamëz ndërmerr gjatë vitit.

## Përmbajtja e raportit

Për një vlerësim sa më gjithëpërfshirës dhe realist, raporti vjetor do të përfshijë:

- ▶ **përshkrimin e të gjitha veprimtarive të realizuara** në kuadër të planit, sipas objektivave strategjike,
- ▶ **analizën e përparimit** drejt përbushjes së objektivave të POLITIKAVE I-IV,
- ▶ **vlerësimin e indikatorëve të performancës**, ku secili aktivitet do të matet sipas treguesve të përcaktuar në planin e veprimit,
- ▶ **analizën e pjesëmarrjes së të rinjve**, duke vlerësuar diversitetin, përfshirjen gjinore dhe përfaqësimin e grupimeve vulnerabël,
- ▶ **identifikimin e sfidave** strukturore, financiare dhe organizative, të cilat kanë ndikuar në realizimin e aktiviteteve,
- ▶ **vlerësimin e ndikimit**, pra se si aktivitetet kanë ndikuar realisht në jetën e të rinjve, mirëqenien, mundësitë dhe aktivizimin komunitar,
- ▶ **rekomandime konkrete** për përmirësimin e programimit, planifikimit dhe bashkëpunimit ndër-institucional.

Të dhënat e raportit do të mbledhen përmes anketave, intervistave të strukturuar, fokus-grupeve me të rinj dhe ekspertë, shkollat, qendrat rinore, Drejtoritë e Bashkisë dhe organizatat partnere.

## Transparenca dhe përfshirja e të rinjve

Transparenca do të jetë një parim kyç i monitorimit. Bashkia Kamëz do të ndërmarrë këto veprime:

- ▶ **publikimin e raportit vjetor** në faqen zyrtare të Bashkisë dhe në kanalet e komunikimit të Qendrës Rinore,
- ▶ **organizimin e një prezantimi publik** ku do të diskutohen gjetjet kryesore së bashku me të rinjtë, Këshillin Vendor Rinor dhe partnerët lokalë,
- ▶ **përgatitjen e një versioni të thjeshtuar**, vizual dhe miqësor për të rinjtë (infografikë, materiale multimediale, përmbledhje për rrjetet sociale), për të siguruar akses të gjerë në informacion,
- ▶ **krijimin e një mekanizmi konsultimi** pas publikimit, ku të rinjtë dhe partnerët mund të japin sugjerime për vitin pasardhës.

Ky proces do të forcojë kulturën e pjesëmarrjes, transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor, duke rritur besimin e të rinjve tek institucionet dhe politikat lokale.

## Roli i raportit vjetor

Raporti i monitorimit do të shërbejë si:

- ▶ **instrument i llogaridhënies**, duke garantuar transparencë për komunitetin dhe partnerët,
- ▶ **bazë për vendimmarrje të informuar**, duke udhëhequr alokimin e burimeve dhe planifikimin buxhetor për programet rinore,
- ▶ **mjet për rishikimin dhe përmirësimin e planit**, në mënyrë që objektivat dhe aktivitetet të përshtaten me nevojat reale dhe dinamike të të rinjve,
- ▶ **platformë për vlerësimin e impaktit**, duke mundësuar identifikimin e ndërhyrjeve që kanë sjellë rezultate domethënëse.

Përmes këtij mekanizmi të strukturuar monitorimi dhe vlerësimi, Bashkia Kamëz synon të garantojë që Plani Vendor për Rininë të jetë një dokument i gjallë, fleksibël dhe në shërbim të përmirësimit të vazhdueshëm të politikave rinore, duke i vendosur të rinjtë në qendër të zhvillimit lokal.

# **ANEKS**

Plani i veprimit dhe aktivitetet per  
rinië 2026-2030

# Politika 1

FUQIZIMI I ORGANIZIMIT RINOR DHE RRIJJA E PJESËMARRJES RINORE NË JETËN PUBLIKE DHE VENDIMMARRJE

## Rezultatet e pritshme:

- R1. Këshilli Vendor Rinor (KVR) funksional dhe me përfaqësim gjithëpërfshirës.
- R2. Rritje e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendimmarrëse vendore.
- R3. Hapësira dhe mekanizma të qëndrueshëm për nisma, vullnetarizëm dhe zhvillim rinor.

## Dokumentet kryesore që u referohemi:

Ligji nr. 75/2019 "Për Rininë" ( i ndryshuar me ligjin nr. 24/2025, datë 17.3.2025).  
 Ligji Nr. 94/2025 "Për Vullnetarizmin".  
 Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029.  
 Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030.  
 Agjenda Rinia, Paqja dhe Siguria (Youth, Peace and Security Agenda/ YPS).

## Objektivi specifik 1.1

**Forcimi i Këshillit Vendor Rinor dhe rritja e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në vendimmarrje dhe aktivitete vendore**

Treguesit e monitorimit:	Baseline: (2026)	Target: (2030)	Monitorimi
Niveli i funksionalitetit të Këshillit Vendor Rinor (KVR)	KVR pjesërisht funksional, me përfaqësim të kufizuar dhe mbledhje jo të rregullta	KVR plotësisht funksional, me strukturë të qëndrueshme, rregullore pune të miratuar dhe mbledhje të rregullta ≥ 6 mbledhje në vit	Bashkia Kamëz / Drejtoria e Integritit të BE-së dhe Projekteve të Huaja / AKR, KKR
Numri i trajnimeve për anëtarët e KVR dhe të rinjtë	Nuk ka program të strukturuar trajnimi	≥ 20 trajnime dhe ≥ 300 pjesëmarrës të trajnuar deri në 2030	Agjencia Kombëtare e Rinisë / Drejtoria e Integritit të BE-së dhe Projekteve të Huaja / OSHC
Pjesëmarrja e të rinjve në mbledhjet konsultative dhe forume vendore	Pjesëmarrje sporadike, pa të dhëna të dokumentuara	≥ 50% e anëtarëve aktivë dhe ≥ 1,000 pjesëmarrës në aktivitetet konsultative	Bashkia Kamëz / KVR / Organizata të Shoqërisë Civile
Përfaqësimi i grupeve të nën përfaqësuar në Këshillin Vendor Rinor	Rreth 30% vajza, përfaqësim i kufizuar i grupeve vulnerabël	≥ 50% përfaqësim i vajzave, minoriteteve, personave me aftësi të kufizuara dhe grupeve të tjera	KVR / Drejtoria e Integritit të BE-së dhe Projekteve të Huaja
Numri i rekomandimeve të KVR të reflektuara në dokumentet e politikave vendore	2 rekomandime të adresuara	≥ 5 rekomandime të integruara në dokumente strategjike dhe programe buxhetore	Këshilli Bashkiak / KVR
Përdorimi i mekanizmave digjitalë për komunikim dhe konsultim me të rinjtë (Platforma Rinore Lokale)	Nuk ka një platformë të dedikuar	Platformë aktive me ≥ 2000 përdorues dhe ≥ 50 konsultime/njoftime në vit	Qendra Rinore / Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit / KVR
Niveli i kënaqësisë së të rinjve me pjesëmarrjen në vendimmarrje	Nuk ka të dhëna bazë	≥ 75% e të rinjve shprehen të kënaqur (anketim vjetor)	Bashkia Kamëz / KVR / Drejtoria e Komunikimit

MASAT DHE AKTIVITETET	ZBATIMI		AFATI KOHOR	TREGUES	KOSTO (LEKË)					KOSTO TOTALE	Bashkia Kamëz	Donatorë / Inst. të tjera	Hendek Financiar
	Përgjegjës kryesor	Mbështetës			2026	2027	2028	2029	2030				
Rifunksionalizimi dhe fuqizimi i Këshillit Vendor Rinor.	Drejtoria e Integritit të BE-së dhe Projekteve të Huaja	KKR, KVR, OSHC	2026	KVR e fuqizuar & funksionale	110,000	-	-	-	-	110,000	110,000	0	0
Trajnime periodike për anëtarët e KVR mbi pjesëmarrjen rinore, leadershipin dhe advokimin.	AKR	Drejtoria e Arsimit, Rinisë, Sportit, OSHC	2026-2030	Nr. trajnimeve; pjesëmarrës	150,000	150,000	150,000	150,000	150,000	750,000	0	750,000	0
Takime periodike ndërmjet senateve të shkollave dhe Këshillit Rinor për çështje që lidhen me projektet rinore, aktivitete, nisma komunitare, sigurinë dhe problematikat në shkolla, etj	Drejtoria e Integritit të BE-së dhe Projekteve të Huaja; KVR	Shkollat, ZVA	2026-2030	Nr. i takimeve	30,000	30,000	30,000	30,000	30,000	150,000	150,000	0	0
